

VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.10(388)

TETOR 2020 ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

VIZITA



Ilir Meta: Për shqiptarët Dibra është shumë e shtrenjtë, siç është edhe Atdheu për dibranët

FAQE 6

PROPOZIMI



GJENERAL VELI DEDIT T'I JEPET DEKORATA "NDERI I KOMBIT"

FAQE 4

DEKORIMI



DESHMORIT AHMET CAMI I JEPET "Dekorata e Artë e Shqiponjës"

FAQE 5

Kryeyesia e OBVL dhe Familja, homazhe në 1-vjetorin e ndajes nga jeta të Heroit të Popullit dhe "Nderit të Kombit"

Një rrugë në Tiranë me emrin "Gjeneral Rrahman Parllaku"

Ripërtëritja e traditës

Halil RAMA

Tridhjetepesë vjet pas inaugurimit të Muzeut të Kastriotëve në Sinë të Dibrës, një vizitë impresionuese këtu në vendlindjen e Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, e Kreut të Shtetit shqiptar Ilir Meta, do të shërbente për ripërtëritjen e traditës së kësaj zone. Një ditë historike kjo, pasi referuar pikërisht veprës madhore të prof. Kristo Frashërit "Historia e Dibrës", që qëndron hijerëndë përkrah busteve të Gjon, Pal e Gjergj Kastriotit në hyrje të Muzeut, presidenti Meta, ashtu si edhe elita historike e kombit që vizituan këtë muze para dy vitesh, do të "legjitimonte" këtë fshat si vendlindjen e kastriotëve. Historiani i njohur dibran Haki Përnezha, në rolin e ciceronit, ndër të tjera do t'i bënte të njohur vizitorit më të rëndësishëm të këtij muzeu atë që ka lënë si testament Gjon Muzaka që në shekullin e 16-të: "Ta dini se gjyshi i Zotit Skënderbe quhet Pal Kastrioti dhe nuk pati më shumë se dy fshatra të quajtura Sinë dhe Gardh i Poshtëm..." (Gardhi i Poshtëm ndodhet në Muhurr). Besnik Këbej, ish-drejtor i shkollës 8-vjeçare Sinë, autor i librit "Origjina dibrane e Skënderbeut", që kishte ardhur pas tridhjet vitesh në vendin ku shërbeu dekada të tëra dhe që dha kontribut të çmuar në ngritjen e këtij muzeu, do të sillte në kujtesë kohën kur këtu erdhën për të parën herë profesorët e nderuar të historisë, Stefanaq Pollo e Kristo Frashëri. "Pasi i kisha njoftuar me telegram për gjetjen nga nxënësit e shkollës të një medalioni bronzi me diametër 9 cm, me emblemën e Skënderbeut, profesorët Pollo e Frashëri udhëtuan më këmbë 6 orë, që nga Lura për në Sinë, për të bërë ekspertizën e këtij medalioni. Më pas, nën ndikimin e tyre, do të ishte kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Dibrës Skënder Dema që do të urdhëronte ngritjen e këtij muzeu", -thotë ndër të tjera Besnik Këbej.

Vijon në faqen 6



- *Për të përjetësuar emrin dhe veprën e gjeneral Rrahman Parllakut - Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, duke konsideruar propozimin e Kryesisë së OBVL-së (Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ-it), administratori i Njesisë Administrative Nr. 2, Tiranë, z. Florian Pullazi, i ka propozuar kryebashkiaut Veliaj që segmenti rrugor që bashkon rrugën "Ali Demi" me rrugën "Petro Nini Luarasi" të emërtohet "rruga 'Gjeneral Rrahman Parllaku'"*

FAQE 3

DEKORIMI

Presidenti Meta vlerëson krijimtarinë produktive dhe cilësore të kryeredaktorit të gazetës "VETERANI"



"MJESHTËR I MADH", VLERËSIM I MERITUAR PËR GAZETARIN DHE SHKRIMTARIN HALIL RAMA

Nga SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 12

PETRO KOÇI:

SHQIPËRIA DREJTON PËR DY VJET SEKRETARIATIN E SEEDM

FAQE 2

HISTORIA

77 – vjetori, betejat e lavdishme të Brigadës së Tretë Sulmuese

FAQE 2

HISTORIA

78- vjet më më parë u krijua çeta partizane e Martaneshit

Nga Teki Kurti

FAQE 11

FESTA

PËRMETI NDERON HERONJTË, FESTON 77-VJETORIN E ÇLIRIMIT

FAQE 9

POSTMORTUM

SI E KUJTOJ PROFESOR SABITIN!

Dr Leonidha Peppo

FAQE 11

PROFIL

ATË E BIR, ATDHETARË....

Nga Liljana Muça

FAQE 10

HISTORIA

Më 17 tetor, forca të Brigadës goditën me top nga kodrat e Saukut Asamblenë Kuislinge dhe zhvilluan aksione të tjera edhe në qytetin e Tiranës

77 – vjetori, betejat e lavdishme të Brigadës së Tretë Sulmuese



Populli ynë gjatë gjithë historisë së tij, ka përkujtuar dhe festuar me madhësi ngjarjet historike, që tregojnë heroizmin dhe vitalitetin e kombit tonë. I tillë është edhe përkujtimi dhe kremtimi i përvjetorit të 77-të të Brigadës së III-të Sulmuese.

E krijuar më 9 Tetor të vitit 1943, në fshatin Arbanë të zonës luftarake të Pezës, kjo njësi relativisht e madhe për kohën, kishte në përbërje të saj partizanë të çetës së Pezës, të batalioneve “Dajti” e “Ishmi”, intelektualë, të rinj, që erdhën nga qyteti i Tiranës, të gjithë me përvojë dhe të kalitur në betejat e ashpra luftarake me okupatorin, i cili synim kryesor kishte likuidimin e forcave partizane në krahinën e Pezës dhe në zonat rrethore të Tiranës.

Udhëheqja e brigadës bëri organizimin e shpejtë të forcave dhe mjeteve luftarake, caktoi detyrat e njërive më të vogla, sqaroi situatën politike dhe luftarake, dhe menjëherë ra në ndeshje ballore me armikun në zonën e Pezës dhe në pikat më strategjike në periferi të Tiranës. Rrugat luftarake e saj është e gjatë dhe aksionet e saj janë me të vërtetë herokike.

Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare i ngarkoi detyrat të rëndësishme dhe shumë të vështira. Rugën e saj, brigada e vazhdoi në zonën e Dajtit.

Forcat pushtuese, të alarmuara për aksionet dhe dëmtimet e mëdha që pësonin nga partizanët e Brigadës së III-të Sulmuese, organizuan dhe i bënë prita e rezistencë të madhe, sidomos gjatë kalimit për në Çermenikë e në të gjithë zonën e Elbasanit, ku i shkaktoi armikut humbje në njerëz dhe paisje lufte.

Në kushtet e një dimri shumë të egër, me ku-fizime shumë të mëdha në veshëmbathje, armatime e ushqime (që të gjitha këto i rrëmbeheshin armikut, por edhe nga populli ndihmohej e furnizohej) mundi t'i plotësojë me sukses detyrat shumë të vështira kundër një armiku shumë të madh në forca e mjete luftarake.

Një nga aksionet e suksesshme ka qenë mbajtja nën goditje dhe ndërprerja e herë pas herëshme e rrugës Elbasan-Tiranë, gjë që pengonte dhe bënte të dështonin veprimet e goditjet e armikut, që e kishte të domosdoshme lëvizjen në Jug e në veri të vendit. Vetë komandanti i batalionit gjerman, kapiteni Llokmann, në kujtimet e tij thekson: “Luftimet e Arbanës kanë qenë më të ashprat që kam kaluar në Ballkan, që janë zhvilluar deri në përleshje ballore. U futëm në një kazan values nga i cili nuk dilnim dot, por falë

perëndimit të diellit, errësira na shpëtoi nga asgjësimi”, se “nuk po luftonim me partizanë, por me një ushtri të përgaditur mirë”.

Më 17 tetor, njësi të Brigadës goditën me top nga kodrat e Saukut Asamblenë Kuislinge dhe zhvilluan aksione të tjera edhe në qytetin e Tiranës. Marshimi luftarak vazhdoi në zonën e Skraparit dhe Përmetit. Gjatë luftimeve që u zhvilluan në Sukën e Përmetit, të drejtuar nga “Heroi i Popullit” Myslim Keta, iu shkaktua armikut një humbje e madhe dhe u bë e mundur të shpëtohet jeta e 17 fshatarëve, që ishin të zënë robër e që do të pushkatoheshin.

Brigada mori detyrë që në përbërje të Divizionit të I-rë Sulmues, me luftime të marshonte në drejtim të Verilindjes, Tiranë-Martanesh-Peshkopi-Kukës-Has dhe për në Malësinë e Gjakovës, nëpër një terren shumë ët thyer e malor, duke kaluar Drinin e Zi e Drinin e Bardhë, në një dimër të ashpër. Në bashkëpunim me Brigadën e V-të Sulmuese, luftime të ashpra kemi zhvilluar në zonën e Peshkopisë e të Kukësit.

Me çlirimin e Tropojës në Tetor, luftime shumë të ashpra e të përgjakshme janë zhvilluar në zonën e Junikut në Kosovë, për çlirimin e Rrafshit të Dukagjinit, të qytetit të Gjakovës e të Pejës.

Detyrat luftarake vazhduan në drejtim të Malit të Zi e deri në Sanxhak të ish Jugosllavisë.

Heroizmi luftarak, trimëria deri në përleshje me armikun, dashuria deri në vdekje mes partizanëve ishin cilësitë e vjera të efektivit.

Në luftime dhanë jetën shumë partizanë e patri-zane të kësaj brigade si “Heroina e Popullit” Ylbere Bylikbashi, komisar Bërçe Sinomati, dëshmorët Kapo Ademi, Kozma Papa, Sali Ymeri, Ali Dervishi e shumë të tjerë. Në Dhjetor të vitit 1945, brigada kthehet në Atdhe duke plotësuar detyrat për çlirimin e Atdheut, gjithashtu edhe në ndihmë të popujve të ish-Jugosllavisë, udhëheqja e së cilës asnjëherë nuk i vlerësoi veprimet luftarake të brigadave e divizioneve tona partizane, pa ndihmën e të cilave do të vështirësohej çlirimi i jugosllavisë. Përkundrazi, udhëheqja e Beogradit, për gjysmë shekulli, shfrytëzoi dhe keqtrajtoi barabarisht popullin shqiptar të Kosovës, duke kaluar deri në genocid dhe asgjësimin fizik të tij.

Falë rezistencës kosovare, ndihmës politike, diplomatike e deri me ndërhyrjen ushtarake të NATO-s dhe mbështetjes së madhe të shtetit e të popullit Shqiptar, Kosova arriti pavarësinë e shumëkërkuar.



SHQIPËRIA DREJTON PËR DY VJET SEKRETARIATIN E SEEDM

Zëvendëssefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjeneral Brigade Manushaqe SHEHU mori pjesë në ceremoninë e aktivizimit të Komandës së SEEBRIG/Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Evropës Juglindore (MPFSEE), ceremoninë e ndërrimit të komandantëve, si dhe në festimin e 21-vjetorit të kësaj njësie, që u zhvillua në Kumanovë të Maqedonisë së Veriut. Në këtë aktivitet mori pjesë edhe ZV/Ministri i Mbrojtjes së Shqipërisë, njëkohësisht Kryetar i SEDM-CC/PMSC, Z. Petro KOÇI,

Gjithashtu morën pjesë: Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, SH.T.Z. Stevo PENDAROVSKI, Kryeministri SH.T.Z. Oliver SPAVOSKI, Ministri i Mbrojtjes, Znj. Radmila SHEKERINSKA, SHSHPFA të Maqedonisë së Veriut, Gjenerallejtënant Vasko GJURCHINOVSKI, ZV/Ministra të Mbrojtjes dhe ZV/SHSHPFA nga vendet e Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Evropës Juglindore (MPFSEE), ambasadorë dhe atashe të Mbrojtjes nga vendet anëtare të PMSC, autoritete lokale dhe personeli i Komandës së SEEBRIG së bashku me familjet e tyre.

Ministri i Mbrojtjes të Maqedonisë së Veriut, Znj. Radmila SHEKERINSKA, Kryetari i SEDM-CC/PMSC Z. Petro KOÇI, Komandanti në detyrë i SEEBRIG, Gjeneral Brigade Tudorica PETRACHE dhe Komandanti i ri i SEEBRIG, Gjeneral Brigade Aristidis ILIOPOULOS, mbajtën fjalën e rastit duke nënvizuar këtë moment të rëndësishëm.

Kryetari i SEDM-CC/PMSC, shprehu vlerësimet dhe falënderimet për autoritetet ushtarake dhe civile të Maqedonisë së Veriut për mbështetjen, për kushtet dhe infrastrukturën e krijuar për Komandën e re të SEEBRIG në Kumanovë, e cila do të jetë “shtëpia e SEEBRIG” për 6 vitet e ardhshme. Ai nënvizoi faktin se Iniciativa e MPFSEE ose e njohur ndryshe si Forca Shumëkombëshe Paqeruajtëse e Evropës Juglindore (SEEBRIG) është një histori suksesi, pasi ka kontribuar shumë në sigurinë dhe stabilitetin rajonal, në besimin reciprok dhe forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë midis vendeve të Evropës Juglindore. Gjatë ceremonisë, Komandanti i SEEBRIG u vlerësua nga Kryetari i SEDM-CC/PMSC, Z. Petro KOÇI, me Medaljen “SEEBRIG Accomplishment Medal” për shërbimin dhe realizimin me sukses të detyrave të ngarkuara.



NDERIMI

Kryesia e OBVL-së dhe Familja, homazhe në 1-vjetorin e ndarjes nga jeta të Heroit të Popullit dhe “Nderit të Kombit”

Një rrugë me emrin “Gjeneral Rrahman Parllaku”

Nga Sakip CAMI

Për të përjetësuar emrin dhe veprën e gjeneral Rrahman Parllakut - Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, duke konsideruar propozimin e Kryesisë së OBVL-së (Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ-it), administratori i Njesisë Administrative Nr. 2, Tiranë, z. Florian Pullazi, i ka propozuar kryebashkiaut Veliaj që segmenti rrugor që bashkon rrugën “Ali Demi” me rrugën “Petro Nini Luarasi” të emërtohet “rruga ‘Gjeneral Rrahman Parllaku’”. Banorët, së bashku me ndërlidhësin me komunitetin, kanë shprehur dakordësinë me këtë propozim. Ky do të ishte vlerësimi më i mirë që iu bëhet qytetarëve të metropolit shqiptar në kuadrin e 100- vjetorit të shpalljes së Tiranës kryeqytet i Shqipërisë.

Para 18 muajsh, me rastin e 100-vjetorit të lindjes, Bashkia e Tiranës e nderoi atë me titullin “Simbol i qytetit të Tiranës”. (Në 95-vjetorin e lindjes, gjeneral Parllakut i është dhënë nga Presidenti i Republikës dekorata e lartë “Nderi i Kombit”). Kryebashkiaku Veliaj e vlerësoi Parllakun si një nga figurat emblem-atike të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që sfidoi edhe regjimin e diktaturës komuniste, si simbol i gjallë i kujtesës patriotike, qytetare dhe historike. Dhe në të vërtetë, ai qe kthyer në simbol të gjallë të kujtesës patriotike, qytetare dhe historike.

Shqiptarët ndihen krenarë me jetën dhe veprën e “Heroit të Popullit” dhe “Nderit të Kombit”, që bëri gjithçka në shërbim të atdheut e kombit. Prandaj, edhe vlerësimet dhe nderimet ndaj veprës së gjeneralit janë plotësisht të merituar. Me gjeneral Parllakun ndihemi krenarë të gjithë. Ai ishte dhe mbetet përmendore e gjallë e traditës dhe e virtutit familjar të trashëguar ndër shekuj.


PËRKUJTOHET 1 VJETORI I NDARJES NGA JETA TË HEROIT TË POPULLIT DHE NDERI I KOMBIT, GJENERALIT RRAHMAN PARLLAKU

Në përvjetorin e parë të vdekjes së heroit, ndonëse në kushtet e COVID 19 OBVL, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste të Popullit Shqiptar, të afërmit dhe familjarët organizuan një përkujtimore. Në emër të OBVL kurorën me lule në varrin e heroit e vendosi Kryetari Kolonel Myfit Guxholli dhe nënkryetari Muharrem Gjoka.

Më pas, nga vajzat e gjeneral Parllakut, Lirika, e Tatjana, si dhe nga nipërit Mazllumi e Hazbiu u organizua një takim-homazh në bar-lulishte 1 “Maji”.

Gjatë kësaj kafeje-homazh, sekretari i Përgjithshëm i OBVL, z.Halil Rama i njohu të pranishmit me propozimin e Administratorit të Njesisë Administrative Nr.2 Tiranë, që ë segmenti rrugor që bashkon rrugën “Ali Demi” me rrugën “Petro Nini Luarasi” të emërtohet “rruga ‘Gjeneral Rrahman Parllaku’”.

Rahman Parllaku u lind në Novosej të Kukësit me 17 prill 1919. Ai u nda nga jeta në moshën 100 vjeçare me 15 shtator 1919, por njerëz si Rrahman Parllaku janë të pavdekshëm sepse bëmat e tyre janë të pavdekshme. Ai nuk vdiq kur u plagos dy herë gjatë luftës nacionalçlirimtare, nuk vdiq kur e burgosën dhe e internuan gjatë diktaturës komuniste. Nuk vdiq pasi nuk vdesin heronjtë e këtij populli të pavdekshëm.



- **Rrahman Parllaku, Hero i Popullit, për merita në Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare, Nderi i Kombit, ish komandant i Divizionit të V gjatë LANÇ, Gjeneral Lejtant dhe Zv ministër i Mbrojtjes, Zv Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare, i burgosur politik me 25 vjet nga regjimi diktatorial, Kryetar i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare të Popullit Shqiptar deri sa vdiq, tashmë Kryetar Nderi**

Rrahman Parllaku është nga Novosej i Kukësit, nga Luma, nga ai vend ku nga një pasha turk e mbysnin për vjet ashtu siç thotë kënga popullore “Djemtë e Lumës nuk kanë dert, nga një pashë e mbysin përvjet”. Është nga ai vend ku serbët u zbrapsën me turp sepse udhëhiqeshin nga kryetrimat Ramadan Zaskoci e Islam Spahia. I rritur në këtë vend me kaq shumë tradita të mëdha patriotike nuk kishte si të dilte ndryshe, veçse të bëhej edhe Ai një hero i popullit shqiptar.

Djaloshi kuksian e filloi veprimtarinë e tij luftarake në Vlorë që më 28 nëntor 1941, ku shumë shpejt u bë drejtues dhe organizator i grupeve guerile të këtij qyteti të Jugut të Shqipërisë. Më vonë u bë komisar batalioni batalioni në Br V S, Zv Komisar i Br VIII S, komandant i Divizionit të V në nëntor 1944 dhe komisar i Korparmatës së II në prill 1945.

I plagosur në Kallarat të Kurveleshit dhe në Junik të Kosovës, ai është shembull i trimërisë mbarëkombëtare dhe i qëndresës njerëzore.

Rrahman Parllaku është njeriu që gjithë jetën e tij ja kushtoi luftës nacionalçlirimtare, ushtrisë shqiptare dhe çështjes mbarëkombëtare.

Drejtor Politik më 1948, Zëvendës ministër i mbrojtjes më 1952, Zëvendës Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Gjeneral Lejtant me gradë të fituar në luftë dhe në betejat e mbrojtjes së atdheut, komandant i forcave tokësore, detare, ajrore dhe i logjistikës, ushtaraku që njihte çdo rrahje të zemrës së uhtsisë, ky ishte Rrahman Parllaku. Heroi i Popullit shqiptar, Hero i Popujve që luftuan dhe fituan në Luftën e II Botërore, Gjeneral Rrahman Parllaku u burgos nga

diktatura komuniste sepse njerëz të tillë viganë, patriot dhe të përgatitur nuk i donte diktatura.

Por a burgosen viganët, a vdesin heronjtë. Sigurisht që jo. Përsëri në krye të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Popullit Shqiptar qëndron Heroi i Popullit Rrahman Parllaku.

Gjatë luftës së Kosovës në vitin 1999 shkon për herë të dytë në Kosovë në krye të një grupi të madhe veteranësh të LANÇ-it për të dhënë edhe një herë tjetër kontributin e tij. Në vitin 2002 si rrallë kush, kur politikanët dhe historianët strukeshin, Gjeneral Rrahman Parllaku deklaroi në një konferencë para Lordit Robertson , Sekretar i Përgjithshëm i NATO_s dhe Sekretar Britanik I Punëve të Jashtme se shqiptarët e Maqedonisë nuk janë terroristë, por luftëtarë për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Ata nuk vrasin gra e fëmijë. Ata mbrojnë të drejtat e tyre që pushteti ua ka mohuar.

Marrëveshja e Ohrit ishte rrjedhojë edhe e ngritjes së zërit para ndërkombëtarëve nga burra trima si Rrahman Parllaku.

Është fat që të kesh personalitete si Rrahman Parllaku. Provkimeve dashakeqe se Lufta Antifashiste e Popullit Shqiptar ishte luftë civile, ai i është përgjigjur me forcë në çdo media. LANÇ ishte një luftë e lavdishme që e rreshtoi popullin shqiptar përkrah fitimtarëve, përkrah aleancës antifashiste të Luftës së II Botërore.

Kombet i mbajnë në këmbë popujt dhe heronjtë. Heronjtë nuk mposhten. Heronjtë nuk vdesin. Rron lavdia e tyre. Rron dhe do të rrojë në shekuj Shqipëria që do t'i nderojë bijtë e saj.



PROPOZIMI

Gjeneral Veli Dedit t'i jepet dekorata "NDERI I KOMBIT"

• *Një takim i ngrohtë e miqësor i kryetarit të OBVL-së, kolonel Ing. Myfit Guxhollit, sekretarit të Përgjithshëm z. Halil Rama, anëtarit të Kryesisë së Organizatës sonë, nënkolonel Ali Demushi dhe përgjegjësit të sektorit të organizimit z. Trifon Llupo, me Znj. Leme Xhema, ish-nënkryetare e komunës së Preshevës pati në fokus vlerësimin e personalitetit të gjeneral-major Veli Dedi.*

Znj. Xhema, mbesë e Heroit të Popullit Veli Dedi shprehu mirënjohjen për propozimin që OBVL i ka bërë Presidentit të Republikës për t'i akorduar luftëtarit internacionalist, patriotit e trimit të madh shqiptar nga Kosova dekoratën "Nderi i Kombit".

Kryesia e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ (OBVL), duke i shprehur mirënjohjen më të thellë për mbështetjen që i ka dhënë organizatës sonë, i ka propozuar Presidentit të Republikës SH T Z. Ilir Meta për të vlerësuar gjeneral-major Veli Dedi me Dekoraten "Nderi i Kombit", me motivacionin: "PATRIOT E TRIM I MADH SHQIPTAR NGA KOSOVA, LUFTËTAR INTERNACIONALIST PËR LIRINË E POPULLIT SPANJOLL E FRANCEZ, NË LUFTËN E DYTË BOTËRORE 1936-1945, HEROI I POPULLIT SHQIPTAR".

Kur fashistët e Frankos iu versulen Spanjës Republikane në 1936-ën Veliu u nis në mbrojtje të lirisë së popullit spanjoll bashkë me Asim Vokshin, Ramiz Varvaricen, Xhemal Kodën, Zef Hotin, Musa Fratarin, Thimio Gogozotin, Petro Markon, Justina Shkupin, Skender Luarasin etj. Veliu fillimisht luftoi me Brigaden "Garibaldi" përkrah brigadave internacionaliste të 57 vendeve të botës, përfshirë batalionin "Abraham Linkoln" të Amerikës. Frontet kryesore ku luftoi ai ishin fronti i Madridit, Aragonës, Barcelonës, Ebros etj. Në vitin 1937 gradohet kapiten dhe u emrua shef i Xhenios dhe shef operativ i Divizionit të Ebros. Për aftësitë që shfaqti në fushën e luftës dhe betejat e zhvilluara, me guximin dhe trimërinë që e karakterizonte në çdo front të luftës në 1938 dekorohet me Urdhërin "Kavalier i Lirisë".

Në vitin 1939 kur Revolucioni Spanjoll u mbyt me gjak nga fash-



istët e Frankos e Musolinit, Veliu me shumë antifashiste të tjerë kaloi nga Spanja në Francë, për të vazhduar më tej luftën kundër pushtuesit nazist të Francës. Pas çlirimit të Marsejës në vitin 1945- së Veliu me repartin e tij luftoi në frontin Italo - Francez të Nicës po me atë trimëri e vendosmëri.

Por Veliu, sytë e zemren i kishte gjithnjë te Atdheu, Shqipëria, Kosova e trojet etnike shqiptare, kështu që në vitin 1946 kthehet në Shqipëri me gradën e majorit francez, së bashku me bashkëshorten e tij Elena, një italiane, antifashiste dhe bashkëpunëtore në Marsejë e cila iu bë

krah gjatë gjithë jetës së tij.

Nga viti 1946-1955, Veli Dedi kreu disa detyra shtetërore në Shqipëri si: Drejtor i Xhenios në Ministrinë e Mbrojtjes, Komandant për Granizonin Ushtarak të Tiranës dhe Drejtor i Arkivit të Shtetit Shqiptar.

Gjatë kësaj periudhe u gradua Gjeneral major dhe iu dha titulli i lartë "Heroi i Popullit Shqiptar".

Pas daljes në pension, Gjeneral Veli Dedi u zgjodh Sekretar i Përgjithshëm i Komitetit Kombëtar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, për shumë vite me rradhë dhe njëherësh u zgjodh Anëtar i Forumit Drejtues të Federatës Internacionale të Rezistencës Antifashiste Botërore (FIR).

Gjeneral major Veli Dedi për dy dekada u zgjodh deputet i rrethit të Tropojës (Malesi e Gjakovës), populli i të cilit, me malësor, intelektual e ushtarak, të rinjë e të moshuar e mbajten në mesin e tyre, në votrat e tyre, si njeriun e veçantë të zemres së tyre, për përfaqësimin e denjë që u bënte ai në Kuvendin e Shqipërisë, për zgjidhjen e halleve e problemeve që kishin, si për shkollimin e fëmijëve, për gjendjen shëndetësore, për punësimin, për rrugët e kushtet e jetesës.

Vlerësimi i kontributit të gjeneral Veli Dedit, duke e dekoruar me "Nderi i Kombit", do të ishte vlerësim për Organizatën tonë të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ, e cila prej 26 vitesh që nga krijimi i është përkushtuar edukimit atdhetar të shoqërisë dhe të brezave.

Përgatiti: Ali Demushi,
Nënkolonel në pension
Kryetar OBVL Dega Shkodër



CURRICULUM VITAE GJENERAL MAJOR VELI DEDI, HERO I POPULLIT

- Lindi me 5 Prill 1912, në fshatin Dedë të komunës së Mëdvegjës në Kosovën Lindore.
- Shkollën fillore e kreu në Mëdvegjë, të mesmen në Leskoc dhe fakultetin e makinerisë në Beograd.
- Në vitin 1932 ujen në Shqipëri ku vazhdon Shkollën Mbretërore të Oficerëve. Në Shqipëri njihet me Ali Kelmendin, Asim Vokshin, Bedri Pejandin, Emrush Myftarin, etj.
- Në vitin 1934-1936 shkon në Itali dhe kryen Akademinë Ushtarake të Xhenjos dhe Artilerisë në Torino.
- Nga 1936-1939 luftoi në Spanjë si luftëtar internacionalist kundër fashistëve të Frankos e Musolinit i inkadruar fillimisht në brigadën "Garibaldi".
- Në vitin 1937 gradohet kapiten dhe emërohet Shef Xhenjo e Shef Operativ i Divizionit të Ebros.
- Në vitin 1938, për trimërinë e treguar në luftë në Spanjë, dekorohet me urdhërin "Kavalier i Lirisë" dhe njihet me emrin Vaillant Albanais (Trimi Shqipëtar).
- Nga 1942-1945, luftoi në Francë kundër nazifashistëve të Hitlerit dhe Musolinit.
- Në vitin 1944, në cilësinë e Komandantit të forcave të rezistencës për Marsejën në Francë, çliroi qytetin e Marsejës dhe duke prirë në ballë të forcave kryengritëse me flamurin Francez të fitores e vendos atë në kështjellën e Marsejës me thirrjen "Rroftë Franca e Lirë".
- Në vitin 1945, bashkë me forcat e tij luftoi në Nicë në frontin franko-italian të Luftës së Dytë botërore kundër nazifashistëve.
- Në vitin 1945 kthehet në Shqipëri me gradën e Majorit francez.
- **Nga viti 1946-1955, kreu disa detyra shtetërore në Shqipëri:**
- Drejtor i Xhenios në Ministrinë e Mbrojtjes.
- Komandant i Garnizonit Ushtarak në Tiranë.
- Drejtor i Arkivit të Shtetit Shqiptar.
- Në Shqipëri mori gradën Gjeneral Major dhe titullin e lartë "Hero i Popullit".
- Pas daljes në pension për shumë vite u zgjodh Sekretar i Përgjithshëm i Komitetit Kombëtar të Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare dhe Anëtar i Forumit Drejtues të Federatës Internacionale të Rezistencës Antifashiste (FIR).
- Për dy dekada është zgjedhur deputet i rrethit të Tropojës.
- Zotëronte 6 gjuhë të huaja e merrej me punë shkencore.
- Vdiq me 03.02.1995 në Tiranë, u përcoll me ceremoni si Gjeneral e Hero, ku fjalën e rastit e mbajti ish Ministri i Mbrojtjes Alfred Moisiu (më pas President i Republikës).
- Gjeneral Veli Dedi, ka meritë të veçantë për faktin se mundi të bindte që të dorëzoheshin 37 mijë fashista që po luftonin për të rrënuar qytetin e Marsejës në 1944.
- Po kështu ka meritë të veçantë për çmimin e 40 km front bregdetar të Shqipërisë, të minuara gjatë luftës së Dytë Botërore nga nazistët gjermanë.
- Është për tu marrë në konsideratë që ish Atashehu Ushtarak Francez në Shqipëri në vitin 1995, pjesëmarrës në ceremoninë mortore për Gjeneral Velinë u shpreh: "...më vjen keq që një shqiptar që ka luftuar për çlirimin e popullit tim, unë e takoj të vdekur..."



DEKORIMI

PRESIDENTI I REPUBLIKËS ILIR META VLERËSON PROPOZIMIN E OBVL-së DHE TË BASHKISË BULQIZË

DESHMORIT AHMET CAMI I JEPET “Dekorata e Artë e Shqiptonjës”



Me dekretin e Presidentit të Republikës, SHT T.Z. Ilir Meta, Nr. 11726 datë 17.09.2020, dëshmorit Ahmet Cami iu akordua “Dekorata e Arte e Shqiptonjës” (pas vdekjes). Ky vlerësim vjen në konsiderim të propozimit të bërë dy vjet më parë nga ish-kryetari i OBVL-së gjeneral Rrahman Parllaku-Hero i Popullit dhe Këshilli Bashkiak i Bulqizës.

E mbesa e dëshmorit Ahmet Cami, dr. Alma Cami, pasi mori dekoratën e dhënë gjatë një ceremonie madhështore në qytetin e Peshkopisë falenderoi Presidentin Meta për këtë nderim që i bëhet një prej drejtuesve të LANÇ në rrethin e Dibrës.

Dëshmorit Ahmet Cami iu akordua “Dekorata e Artë e Shqiptonjës” (pas vdekjes), me motivacionin: “Për kontributin e shquar atdhetar në mbrojtjen e interesave kombëtare, pavarësinë e vendit dhe tërësinë territoriale të shtetit shqiptar. Si komandant i Çetës së Gollobordës gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe luftëtar i paepur në shërbim të atdheut deri në flijimin e jetës”.

Ahmet Fetah Cami, dëshmor i atdheut me përmasat e Heroit është padyshim një nga figurat emblematike të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Madhështinë e tij e rrit qoftë edhe fakti i vrasjes enigmatike nga eksponentë të Çetës serbo-malazeze që vepronte në mënyrë sporadike edhe në Dibër. Është lindur më 8 gusht 1900 në fshatin Viçisht të krahinës së Dibrës, në një familje me tradita atdhetare dhe liri-dashëse.

Që në moshë të re Ahmeti u njoh dhe u frymëzua nga ngjarje dhe episode trimërie dhe heroizmi të popullit shqiptar, të krahinës dhe të paraardhësve të tij si: të stërgjyshit, Mahmut Cami, i vrarë në luftën e Drinit kundër forcave të Hajredin Pashës; të gjyshit, Shaban Mahmut Cami, (Dëshmor i Atdheut me Vendim të Komitetit Ekzekutiv të KP-së të rrethit Dibër Nr. 72, datë 24.05.1978) i vrarë në luftë për mbrojtjen e trojeve shqiptare nga sulmet e forcave shoviniste bullgare; të babait, Fetah Shaban Cami, (Dëshmor i Atdheut me Vendim të Komitetit Ekzekutiv të KP-së të rrethit Dibër Nr. 73 datë 24.05.1978 që, si komandant për mbrojtjen e krahinës, është vrarë dhe masakruar nga shovinistët serbë, të cilët e kanë zhvarrosur pas një jave dhe e kanë fotografuar për t’ia çuar Pashiqit, kryeministrit të Serbisë, si dëshmi të vrasjes së atij heroi. Mësimet e para i mori në shkollën e Zërqanit.

Vazhdoi studimet dhe kreu arsimin e plotë ushtarak në Akademinë Ushtarake në Shqipëri dhe në Itali. Punoi për disa vite si oficer gjatë sundimit të Zogut në rrethet Shkodër e Gjirokastrë dhe për disa vite në Prefekturën e Elbasanit. Në qytetet ku punoi, Ahmeti u fut në rrethet intelektuale, ku ka marrë pjesë gjallër-

isht në diskutime e debate për probleme kombëtare si për organizimin e ushtrisë, të arsimit e të shkollës kombëtare si dhe për disa reforma shoqërore, duke dhënë kontributin e tij, që të mos ishin gjysmake dhe formale.

Ahmeti e priti me indinjatë të thellë pushtimin fashist italian. Prandaj që ditën e parë të pushtimit të Shqipërisë, tregon ish-kolegu i tij, Isuf Kokomiri: “Ahmeti i ulur në gjunjë puth flamurin kombëtar dhe jep dorëheqjen si oficer”. Shembullin e tij e ndoqën edhe ushtarakë të tjerë, të cilët vazhduan të jepnin dorëheqjen. Kthehet brenda natës në fshatin e tij të lindjes, në Viçisht të Dibrës.

Ai e kishte më se të qartë, se vetëm me luftë të armatosur, mund të çlirohej Shqipëria nga pushtimi fashist italian. Kur kthehet në Dibër, Ahmeti mëson se kishin internuar e çuar në Berat, Ukë Dan Camin (Veteran i LANÇ me vendim të MM të RSH, 1994), kreun e Malit të Gollobordës dhe Sinan Shaban Camin, (Veteran i LANÇ me vendim të MM të RSH, 1994), kryepalokun e fshatit dhe me ndikim në mbarë Gollobordën dhe kishin internuar edhe disa krerë të tjerë të zonës. Sulmi ndaj batalionit të divizionit “Firence” të dislokuar në Vanastrane të fshatit Tërbaç Ahmeti, së bashku me Fasilin, vëllanë e mësuesin e shquar, me Sefer Camin, kushëririn dhe shkrimtarin e ardhshëm; me mësuesin korçar Spiro Velko, si dhe me gjimnazistin e Tiranës që ndiqej nga regjimi fashist, Ejup Shahin Camin dhe Ukë Dull Camin përbënin një bërthamë intelektualësh antifashistë në këtë zonë.

Ata shfrytëzonin të gjitha rastet, që nga festat familjare e fetare, lidhjet farefisnore, miqësore e shoqërore, deri edhe grumbullimet e popullit në paza-re, për t’i njohur masat me situatat e brendshme dhe me ato ndërkombëtare, për të izoluar elementët profashistë, si dhe për marrjen e masave për të organizuar punën kundër fashizmit. Ahmeti është vënë në krye të punës propagandistike për sqarimin e popullit. Më 28



nëntor 1940 ka folur para popullit në Homesh për këtë datë historike, duke u dhënë që të kuptojnë se vetëm të bashkuar në luftë mund t’i dilet zot vendit dhe të çlirohet Shqipëria.

Çeta me bazë fshatin Viçisht ka vepruar që në prill 1941, ku u vranë 50 italianë. Pas pushkatimit të Ejupit, Musait dhe Mexhitit si dhe të vrasjes së Fasilut, burgosjes së 20 burrave të fshatit, çeta u asgjësua dhe u riformua pas daljes nga burgu më 25 maj 1943, datë e cila njihet ligjërisht si Çeta e Gollobordës (Fjalori enciklopedik, botim i vitit 1985).

Në çetë merrnin pjesë: Ahmet Cami, Spiro Velko, Hamdi Lleshi, Uke Cami, Qamil Lika, Mahmut Cami, Mahmut Dani, Esat Cami, Ibrahim Leci, Ibrahim Kotili, Remzi Kurtulla, Çup Duka, Shaqir Pali, Hazis Cami, Ramiz Murra, Mersim Murra, Hidër Manjani, Shaziman Meha, Selman Balla, Mete Duka, Ibrahim Lumi, Isuf Lika, Bajram Toçi, Mexhit Tola, Abaz Vargu, Murat Aliu, Xhezair Adili, Nexhip Duka, Nexhip Meçe, Ibe Palikuqi, Cen Lila, Lilë Hasa, Ibrahim Kasapi, Lutfi Skuka, Zenel Uka, etj.

Më 4-5 prill të vitit 1941 është organizuar aksioni për të sulmuar çadtrat e batalionit të divizionit “Firence” të dislokuar në Vanastrane të fshatit Tërbaç, me një efektiv prej 600 ushtarësh italianë. Në këtë aksion u kanë rrëmbyer italianëve shumë armë dhe janë vrarë disa italianë si dhe një oficer i tyre. Ndërsa forcat e çetës nuk kanë pësuar asgjë, sepse aksioni që i mirëorganizuar me detaje. Me armët e rrëmbyera në atë aksion janë armatosur të gjithë luftëtarët e krahinës.

AKTIVITETI KRYESOR I ÇETËS SË GOLLOBORDËS

Aksionet luftarake të Çetës së Gollobordës janë zhvilluar në fshatrat Trebisht, Ostren, Radovesh dhe Viçisht. Ajo ka vepruar e vetme dhe me çeta të tjera në kuadër të batalionit të Dibrës dhe më vonë në kuadër të Brigadës 18-të S. Janë të njohura dy aksione në rrugën automobilistike Strugë-Dibër, Çlirimi i Trebishtit, Çlirimi i Zërqanit, Çlirimi i Ostrenit, Lufta e Sofraçanit, dy luftërat e Dibrës së Madhe, Lufta e Peshkopisë etj.

Formimi i Batalionit të Dibrës më 26 korrik 1943 dhe roli i Çetës së Gollobordës për sigurinë e formimit të batalionit Fashistët u përpoqën t’i ndalonin, duke u bërë presione popullit të Gjoricës, por toka ku do të bëhej organizimi i batalionit ishte pronë e Zenel Camit dhe e pasuesve të tij, ishte kulla e Mahmut Camit, dhe për rrjedhojë askush nuk mund ta ndalonte. Influenca e Ahmet Camit, që jo rastësisht mbante edhe emrin e babait të Zenel Camit ishte e madhe.

Këtu një ndihmë konkrete dha edhe imami i Gjoricës, Sheh Latifi i cili kishte

të falura katër hektarë tokë nga Cami. Në përbërje të batalionit ishin Çeta e Sllovës, Çeta e Grykës së Vogël, Çeta e Grykës së Madhe dhe një pjesë nga Çeta e Gollobordës, skuadra për ruajtjen e vendit të grumbullimit të batalionit, luftëtarë nga fisi Cami dhe nga Gjorica. Për ruajtjen e vendit të formimit të batalionit kanë qenë të ngarkuar këto partizanë efektiv të Çetës së Gollobordës: Çup Duka, Mete Duka, (dajat e Ahmetit), Ibrahim Leci nga Gjorica, Bajram Toçi, Qamil Lika dhe Uke Dullë Cami nga Viçisht etj.

Batalioni është formuar në kullen e Mahmut Camit në Gjoricë. Kuvendi për krijimin e Batalionit të Dibrës zgjodhi Shtabin e Batalionit me komandant Haxhi Lleshin, zv/komandant Esat Elez Isufin, komisar Njazi Islamin, zv/komisar Prokop Murrën. Ditën e formimit të batalionit, Ahmeti u caktua përsëri komandant i Çetës së Gollobordës dhe anëtar i shtabit të batalionit

VRASJA ENIGMATIKE E AHMETIT NË LUFTËN E PESHKOPISË, TETOR 1943

Nga dokumentet arkivore del se, në krah të Çetës partizane të Gollobordës ka qenë vetëm Çeta e Sharrit me përbërje prej 45 partizanësh serbo-malazezë. Paria e Dibrës dhe krerët e Ballit Kombëtar në takim me përfaqësuesit e Frontit kishin kërkuar, që të largoheshin jabanxhinjtë nga Dibra, që bëhej fjalë për çetën serbo-malazeze. Në maketin e historikut të Dibrës të para vitit 1990 nuk përmendet prania e çetës serbomalazeze. Me të drejtë, del pyetja: Pse duhej të ishte ajo çetë jugosllave brenda kufirit të Shqipërisë? Vrasjen e Ahmet Camit si nacionalist, që e cilësuan jugosllavët, mund ta bënte vetëm çeta serbo-malazeze, ashtu siç e realizoi.

Ahmet Cami dha për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, për lirinë dhe pavarësinë e atdheut gjithçka kishte. Ai shkriu të gjithë pasurinë e tij, duke dhënë edhe jetën. Akti i heroizmit të Ahmetit dhe të shokëve të tij, e frymëzuan Çetën e Gollobordës, për ta vazhduar më me guxim e heroizëm luftën për çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit nazistë. Populli i kësaj krahine e ngriti lart emrin e Ahmet Camit, duke e vazhduar më me vrull luftën. Çeta e Gollobordës mori emërtimin “Çeta Ahmet Cami”. Ahmet Camit, për kontributin e dhënë në Luftën Nacionalçlirimtare, iu akorduan Medalja e Kujtimit, Medalja e Trimërisë dhe Medalja e Çlirimit. Në vitet 1966 dhe 1967, nga strukturat përkatëse të rrethit të Dibrës i është propozuar dy vite rresht Presidiumit të Kuvendit Popullor që t’i jepej titulli “Hero i Popullit”, për qëndrim patriotik dhe heroik gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, por ky titull nuk iu dha, për një arsye të vetme, se nuk kishte qenë anëtar i Partisë Komuniste Shqiptare.

VIZITA

Ilir Meta: Për shqiptarët Dibra është shumë e shtrenjtë, siç është edhe Atdheu për dibranët

Presidenti i Republikës, Sh.T.Z. Ilir Meta në vijim të vizitës së Tij të punës në Qarkun e Dibrës, më 19 shtator 2020 u ndal në qytetin e Peshkopisë, ku me anë të një ceremonie solemne vlerësoi figura të shquara atdhetarësh dhe artistësh dibranë.

Presidenti Meta i shoqëruar nga Kryetari i Bashkisë, Dionis Imeraj, autoritetet vendore, përfaqësues të të gjitha forcave politike, si dhe qindra qytetarë të Peshkopisë të cilit kishin dalë për ta mikpritur, vendosi një buqetë me lule në bustin e Elez Isuf Ndreut dhe u përul me respekt e mirënjohje para veprës dhe jetës së tij.

Gjatë ceremonisë solemne të organizuar në Pallatin e Kulturës së Peshkopisë, ku ndoqi një koncert festiv me këngë e valle dibrane, Kreu i Shtetit çmoi me "Dekoratën e Flamurit Kombëtar", më të lartën në Republikën e Shqipërisë, atdhetarin Elez Isuf Ndreu (pas vdekjes); me "Dekoratën e Artë të Shqiponjës" Ahmet Camin (pas vdekjes); ndërsa me Dekoratën "Nderi i Kombit" Edip Tërshanën (pas vdekjes) dhe Hazis Ndreun (pas vdekjes).

Me Titullin "Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut" Presidenti Meta dekoroi kompozitorin, orkestruesin dhe producentin muzikor z. Edmond Zhulali, si dhe artistin e mirënjohur z. Arif Vladi, ndërsa me Titullin "Kalorës i Urdhrit të Flamurit", z. Muharrem Xhediku.

Me Titullin "Mjeshtër i Madh" u vlerësua Përparim Tomçini (Pas vdekjes), z. Behar Mera, znj. Vera Duka (Laçi), z. Isak Shehu dhe z. Hysen Ndreu.

Në fjalën përshëndetëse të mbajtur me këtë rast, Presidenti Meta theksoi se:

"Vizita në Dibër dhe takimi me dibranët është përherë një kënaqësi e veçantë për mua!"

Vizita në Dibër pasi lexon nga fillimi deri në fund edhe librin e njërit prej historianëve më të mëdhenj të vendit tonë, Prof. Kristo Frashërit është edhe më e veçantë.

Për më tepër kur kjo vizitë lidhet me vlerësimin e eposit dibran të këngës, artit, kulturës, folklorit dhe muzikës.

Gjithë kombi përulet me nderim e mirënjohje ndaj kontributit të dibranëve për lirinë dhe pavarësinë e Atdheut, por edhe për ndikimin e madh që Dibra dhe dibranët kanë pasur në botën dhe kulturën shqiptare.

Për shqiptarët Dibra është shumë e shtrenjtë, siç është edhe Atdheu për dibranët. Ajo ka qenë dhe mbetet një nga epiqendrat më spikatura dhe më të flakta të shqiptarizmit dhe betejave për liri!

Mbijetesa e dibranëve është e lidhur ngushtë me mbijetesën e gjithë kombit shqiptar.

Kjo qëndresë e përbashkët i ka rrënjët të shkalla e lartë e atdhedashurisë, solidariteti, sakrificë, përkushtimi dhe kontributi i gjithë brezave të dibranëve ndër shekuj.

Dibranët janë ndjerë përherë ballëllartë dhe krenarë para historisë.

• Gjithë kombi përulet me nderim e mirënjohje ndaj kontributit të dibranëve për lirinë dhe pavarësinë e Atdheut, por edhe për ndikimin e madh që Dibra dhe dibranët kanë pasur në botën dhe kulturën shqiptare



Treva e Dibrës me nëntë malet e saj të lartë ka qenë në shekuj kështjella natyrale e lirisë së shqiptarëve.

Dibra ngeli përherë bastioni dhe barrikada e parë e betejave ndaj vërshimit të hordhive të ushtrive pushtuese në kufirin verilindor të shqiptarëve.

Ndaj dhe gjigandi Hazis Ndreu do të këndonte:

"Hajredin Pasha po vjen Radikës/Pyet ku janë malet e Dibrës?/E ka gjet belaja si e ka gjet/ Shtat taborë i jan ba shkret".

Kjo tokë e lashtë e bijve krenarë ka qenë arena e përgjakshme e luftërave dhe fitoreve të Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeut, për të cilin me të drejtë Fan Noli ka thënë se do të jetë gjithmonë më i gjalli ndër shqiptarët e gjallë, sepse edhe sot ai na frymëzon, na bashkon dhe na jep forcë.

19 nga 24 betejat e tij, Skënderbeu i zhvilloi dhe i fitoi në trojet e dibranëve, dhe jo rastësisht kapëdanët ndër më të shquarit e tij ishin dibranët Moisi Golemi, Pal Kuka, Vladan Gjurica e Zakaria Gro-pa e shumë të tjerë.

Kontributi njerëzor dhe sakrificat e dibranëve kanë qenë biblike, sikurse vetë historia e Skënderbeut.

Në librin e historisë së kësaj epopeje të ndritur do të shkruhej se çdo dibran ishte dhe mbeti një luftëtar i Skënderbeut, këtij simboli të përjetshëm të identitetit tonë kombëtar.

Edhe gjatë sundimit otoman dibranët nuk e ndalën luftën për liri.

Ata mbështetën Lidhjen e Prizrenit dhe u bënë organizatorët Kuvendeve të famshme të maleve, që u drejtuan nga atdhetarët Iljaz pashë Dibra, Selim Rusi, Vehbi Dibra, Isuf Karasani, Ramiz Daci, Elez Isufi, etj.

Në 28 Nëntor të vitit 1912, Dibranët ishin mbrojtës e flaktë të aktit të Pavarësisë dhe njëkohësisht edhe të Qeverisë së Ismail Qemalit.



Ata u përfaqësuan në Vlorë me dy nga përfaqësuesit më të shquar të saj si atdhetarët Nikoll Kaçorri dhe Vehbi Dibra.

Të panumërta janë betejat dhe përpjekjet e dibranëve në luftën Antifashiste Nacional-Çlirimtare.

Të rreshtuar në dy Brigada dhe shumë çeta ata i falën atdheut 6 Heronj të popullit dhe 176 Dëshmorë!

Nder dhe lavdi përjetë heronjve dhe dëshmorëve të Dibrës e mbarë kombit tonë!" – u shpreh Presidenti i Republikës.

"Para disa ditësh ne festuam me madhësi 100-Vjetorin e Luftës së Vlorës, e cila shënoi jo vetëm çlimin e Vlorës, por edhe të mbarë Shqipërisë nga pushtuesit që nga viti 1912!"

Por Shqipëria e sotme nuk do të ishte kurrë e plotë pa luftën dhe betejat heroike të dibranëve kundër pushtuesve serbë, si dhe të shkodranëve kundër atyre malazezë.

Rrallë ka ndodhur që një krahinë e vetme të zhvillojë për 9 vjet rresht një qëndresë kaq heroike për mbrojtjen e territoreve shqiptare!

Dibranët iu thanë 'Jo!' vendimeve të Fuqive të Mëdha për copëtimin e Shqipërisë dhe të vetë Dibrës dhe u hodhën në luftë dhe sakrificë pa fund, derisa ia arritën që t'i detyrojnë ushtritë serbe të tërhiqeshin jashtë kufijve.

Nder e lavdi prijësve dhe komandatëve dibranë Elez Isufi, Ramiz Dibra, Dine e Izet Maqellara, Ramiz Daci, Shaqir e Dine Dema, Dine Hoxha, Selim Noka, Murat Kaloshi e Dervish Lusha, e shumë të tjerë!

Këtë fagë të ndritur të luftëtarëve dibranë populli e ka skalitur:

Elez Isufi, arusha e malit / Fort po e vret asqerin e krahut / Fort po i vret e po bën kërdi / o në k'to brigjet e Drinit të Zi!"

Kjo trevë e kaq e bukur, me këtë histori dinjitoze, me këtë panoramë mahnitëse dhe me këtë popull me kaq virtyte nuk duhet të braktiset më!

Ky shpopullim është i dhembshëm, pasi braktisja e këtyre krahinave tradicionale që kanë qenë burimi i identitetit tonë kombëtar edhe kulturor, mund të jetë fatal për të gjithë kombin.

Ndaj është momenti që të gjithë të kthejmë më shumë vëmendjen ndaj ruajtjes jo vetëm të vlerave më të mira të kulturës e identitetit tonë kombëtar, por mbi të gjitha të njerëzve në këto troje! Në mënyrë të veçantë të rinisë.

Është koha t'i kthejmë sytë seriozisht nga bujqësia dhe nga turizmi, sepse ato përfaqësojnë potenciale të jashtëzakonshme për të gjithë banorët

e këtyre trevave.

Është e rëndësishme që për çështjet e mëdha të jemi gjithmonë bashkë, përtej dallimeve politike të ditës. Ash-tu sikurse në vitin 1920 që ishte dhe mbetet një viti i bekuar për Shqipërinë, u bënë të gjithë bashkë.

U bënë bashkë edhe Sulejman Pashë Delvina, edhe Ahmet Zogu, edhe Avni Rustemi, edhe gjithë burrat e Shqipërisë, duke bërë të mundur çlirimin përfundimtar të vendit tonë, dhe duke na lënë këtë shtet që e kemi sot prej 100 vitesh në atë mënyrë dhe në atë nivel, i cili duhet të ruhet e duhet të mbrohet pasi nuk duhet të kemi iluzionet.

Jemi një vend, i cili duhet në çdo moment të mbrojtë vetveten, të mbrojtë Atdheun, dhe ka forma të reja të ndikimit të të tjerëve, të cilat cenojnë sovranitetin e popullit dhe të kombit tonë.

Ndaj të mos i harrojmë kurrë vargjet e të madhit Hazis Ndreu:

"Burrat e Dibrës e kanë lidhun besën / Hej për vatan o nuk tutën se vdesin!" – nënvizoi kreu i shtetit shqiptar"

"Shoqëria bashkëkohore shqiptare ka çfarë të mësojë nga trashëgimia, tiparet, traditat, virtytet e bashkësisë krahinore dibrane.

Cilësitë e civilizimit dibran sikurse janë organizimi i kuvendeve, alegoria e komunikimit si dhe rregullat kanunore qytetare të trevës së Dibrës përbëjnë shembuj të një shoqërie të emancipuar dhe përcjellin edhe sot mesazhe dinjiteti, progresi dhe zgjuarsie të veçantë popullore.

Përsosmëria në organizim, barazia, respektimi i dialogut, mënyra demokratike e vendimmarrjes, sjellja e kulturuar ndaj kundërshtarëve dhe për më tepër zbatimi korrekt i vendimeve përbëjnë një shembull të lartë integriteti etiko-moral.

Këto gjeste fisnike e atdhetare të dibranëve në Kuvendet e Maleve janë edhe sot një mesazh kuptimplotë për klasën politike dhe për shoqërinë tonë.

Në këngët, elegjitë dhe rapsoditë tuaja ju keni mbajtur gjallë dhe ju keni transmetuar brezave historinë dhe krenarinë e të genit dibran.

Në vallet tuaja të larmishme keni reflektuar temperamentin, harmoninë, ritmin dhe energjinë e pashtershme!

Në kostumat tuaja popullore ju keni hedhur ngjyrat e jetës, të pyjeve, maleve, lëndinave, ndërsa këngën e zogjve si dhe gurgullimën e lumenjve e keni

(Vijon në faqen 7)



DEKORIMI

Reportazh/ Ripërtëritja e traditës, 35- vjet pas inaugurimit të Muzeut të Kastriotëve në Sinë, Kreu i Shtetit viziton Dibrën dhe nderon dibranët

Presidenti Meta në vendorigjininën e Kastriotëve...

(vijon nga fq.1)

Ndërsa Presidenti Meta shprehet se njohja e trashëgimisë dhe rrënjëve kombëtare është thelbësore për të ardhmen europiane të vendit. “Sot (18 shtator 2020) në Sinë, në truallin e Kastriotëve, vendin e origjinës të Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Kënaqësi të vizitoja Muzeun Historik dhe të njihesha nga afër me të dhëna interesante për betejat heroike të zhvilluara për mbrojtjen e kombësisë, territorit dhe identitetit tonë europian. Të bëhet zemra mal kur shesh djemtë dhe vajzat e Dibrës të lartësojnë traditat dhe vlerat tona duke na bërë të ndihemi krenarë! Thelbësore që rinia jonë të njohë rrënjët kombëtare, për të mbrojtur më mirë të ardhmen europiane të Shqipërisë”,- deklaroi Presidenti Meta.

SHPOPULLIMI I DIBRËS ËSHTË I DHIMBSHËM

Bahçja e fermerit Shefki Prifti në Sinë të Dibrës, një parajsë e vërtetë! Në këtë vend të begatë, perlë e natyrës, vetëm dy kilometra sipër luginës pjellore të Drinit të Zi, që ka përballë Korabin dhe sipër Runjën hijerëndë e kreshnike, për herë të parë në këto tridhjet vjet vjen Presidenti i Republikës. Dhe Shefki Prifti, një ndër kuadrot e njohur në gjithë Dibrën e pret atë sipas traditës dibrane. Në oborrin mahnitës të shtëpisë së tij janë mbledhur dhjetra fermerë të kësaj zone. Kuvendojnë ata shtruar me kreun e shtetit për “braktisjen qeveritare” të kësaj zone me histori të lavdishme. Ndër të tjera, më i moshuari, Besnik Kaloshi, përçues i denjë i mençurisë dhe filozofisë popullore dibrane do të shprehë se “Skënderbeu e ka lënë të hapur që prej gjashtë shekujsh rrugën e tij nga Sina për në gjithë Shqipërinë, por kjo copë udhë (vetëm dy kilometra nga ura e Arrasit) ka nevojë të asfaltohet e mirëmbahet që këtu të mund të vijnë vizitorë nga e gjithë bota”. Dhe ndërsa ka provuar shijen e rakisë, rrushit, dardhës, kumbullës e të mjaltit të sapo dalë nga hojet e bletëve të Shefki



Priftit, gjatë kuvendimit me vendasit, Presidenti Meta tha se “shpopullimi i Dibrës është i dhimbshëm, pasi sipas tij braktisja e këtyre krahinave tradicionale që kanë qenë burim i identitetit tonë kombëtar e kulturor, mund të jetë fatal për të gjithë kombin”. Dhe vërtetë ndjen dhimbje kur shesh të braktisura këto vise me bukuri të rrallë natyrore, të cilat me pak investime mund të kthehen në një destinacion turistik tërheqës për vizitorë të shumtë vendas e të huaj.

ZALL DARDHA, DJEP I ARTISTËVE

Shtatë dekada më parë, në Zall Dardhë, në këto troje të burrave të mençëm, trima, të besës e bujarë nisi udhën e gjatë, të bukur e plotë suksese, grupi folklorik i Zall Dardhës martire, që bëri emër e zuri vend denjësisht në fondin e kulturës sonë kombëtare. Jo rastësisht, këta burra, simbol të urtësisë, trimërisë e mençurisë dibrane do ta pagëzonin Ansamblin folklorik të tyre me emrin tejet sinjifikativ “KU-

VENDI”. Ka kaluar më shumë se një gjysmë shekulli dhe këngët e vallet e kësaj krahine kanë ushtuar e janë kërcyer jo vetëm në festivale kombëtare, por edhe në ato ndërkombëtare. Zall Dardha quhet djepi i artistëve. Mund të duket e çuditshme, madje e pabesueshme, por ndryshe nga e gjithë bota ku fëmijët lindin duke qarë, në Zall Dardhë, fëmijët lindin duke “kënduar”. S’ka si të shpjegohet ndryshe fakti që në këtë vend ka aq shumë artistë në raport me numrin e popullsisë. Ndodh kështu, jo vetëm për efektet e trashëgimisë historike qëndrestare ndaj armiqve, por edhe për efektet e trashëgimisë kulturore folklorike. Por Muharrem Gjoka, President i Ansambilit “Folk Alb Hazis Ndreu,” thotë se në Zall Dardhë nuk ka shtëpi që nuk ka vegël muzikore popullore, çifteli, fyell, dajre etj. Në këtë zonë lindën dhe u rritën njerëz që lanë gjurmë në muzikën etnike shqiptare si kompozitori i shquar Muharrem Xhediku -themelues i filarmonisë shqiptare, ko-reografi, studiuesi dhe poeti i këngës Hazis Ndreu, artistët Skënder Çala, Lirë Rasha, Qerim Sula, Caje Poleshi, Xhelal Çerpja, Sherif Dervishi, etj. Nuk është rastësi që vetëm nga krahina e Zall Dardhës, janë katër artistë të dekoruar me Titullin “Mjeshtër i Madh”, përkatësisht: Hazis Ndreu, Skënder Çala, Liri Rasha dhe Qerim Sula. Siç është shprehur Presidenti i Republikës Ilir Meta: “Emrat e artistëve Haziz Ndreu, Muharrem Xhediku, Liri Rasha, Qerim Sula, Caje Poleshi, Ramadan Selmani, Shaban Mziu, Sherif Dervishi, Xhelil Ymeri, Xhelal Çerpja dhe shumë të tjerë janë të dashur për gjithë shqiptarët dhe janë bërë zëri i kombit në shumë aktivitete kombëtare e ndërkombëtare”. Janë me dhjetra muzikantët, instrumentistët, valltarët,

këngëtarët popullorë nga Zall Dardha që me kontributin e tyre jo vetëm kanë dhënë shfaqje në Zall Dardhë e Dibër, por edhe në mbarë Shqipërinë, madje edhe në skenat më prestigjioze të Amerikës dhe Europës. Dhe historia riciklohet. Atë që bënë burrat e shquar të Dardhës, para shtatë dekadash, duke themeluar Ansamblin Kuvendi, me në krye shumëtalentuarin Hazis Ndreu, po e ripërtërin Neshat Ndreu-President i Shoqatës “Ansambli Kuvendi Zall Dardhë”. Janë të rrallë burrat si Ai, që edhe në këto kohë të vështira kontribuojnë për ringjalljen e traditës. Realizimi prej tij i vizitës së Presidentit Meta në Zall Dardhë ku u vlerësuan me dekorata të larta artistët më të mirë të kësaj treve: Xhelal Çerpja, Qerim Sula e Sherif Dervishi (pas vdekjes), si dhe Liri Rasha, Saje Poleshi, Xhelil Imeraj, Lutfi Ndreu, Shaban Mëziu, Neshat Ndreu e Agim Cani është shembull frymëzimi për të gjithë ata që duan të promovojnë e trashëgojnë traditat e shkëlqyera të Dardhës.

Presidenti Meta duke dekoruar personalitete të etnografisë, folklorit dhe muzikës popullore shqiptare në Zall Dardhë vlerësoi Dibrën si simbol të qëndresës së shqiptarëve, që ka qenë përherë djepi i luftërave patriotike për liri dhe identitet kulturor. Në ceremoninë solemne të organizuar me këtë rast kreu i shtetit vuri në dukje se ndihet i lumtur që gjendet në Zall Dardhë, në fshatin me histori të madhe të luftërave për liri, por dhe në krahinën e artistëve, rapsodëve dhe valltarëve të famshëm për mbarë kombin! Nder dhe krenari për Hazis Ndreun, të cilit Presidenti Meta i akordoi dekoratën “Nderi i Kombit”. Mirënjohje të thellë për Neshat Ndreun e Avni Ndreun që i dhanë jetë Ansambilit “Kuvendi”.



Ilir Meta: Për shqiptarët Dibra është shumë e shtrenjtë, siç është edhe Atdheu për dibranët

(Vijon nga faqja 6)

pasqyruar në muzikën e këngët tuaja. Ju e keni ruajtur e zhvilluar me dashuri këtë pasuri kulturore deri në ditët tona.

Mbi këtë folklor të lashtë dhe pasuri shpirtërore ju keni ngritur artin, letërsinë, këngën e kulturën dibrane aq të njohur në gjithë vendin.

Sot jam i lumtur të jem mes jush dhe të nderoj një pjesë të atdhetarëve, por edhe të korifjenjve të folklorit, si dhe të artistëve të mëdhenj të Dibrës e të mbarë vendit, por në mënyrë të veçantë, duke qenë se jemi në këtë vend që mban edhe emrin e tij jam shumë i lumtur, të vlerësoj me Dekoratën më të lartë, me ‘Urdhrin e Flamurit’ Elez Isuf Ndreun!

Siç thotë populli: “Shqipëri ka lindur burra që nuk njohin dy flamura!” Dhe Elez Isuf Ndreu është nga burrat më të mëdhenj që nxorri kjo tokë por edhe kombi ynë, i cili luftoi në mënyrë heroike si rrallëkush tjetër, përgjatë gjithë jetës së tij kundër të gjithë pushtuesve që ai njohu dhe ishte kontributi i tij i spikatur sidomos edhe para Pavarësisë, por që nga viti 1912 deri në vitin 1920 që bëri të mundur këtë shtet që ne kemi sot.

Të mësojmë nga gabimet që kemi

bërë këto 100 vite, ta ruajmë e ta forcojmë dhe gjithmonë të jemi krenarë për të parët tanë, për historinë tonë dhe të kemi parasysh se fëmijët tanë çdo gjë mund ta gjejnë jashtë. Mund të gjejnë një punë më të mirë. Mund të bëjnë një aktivitet më të mirë. Por Atdhe nuk mund të gjejnë asgjëkundi në botë!

Të mos harrojmë që të parët tanë ishin në Amerikë, ishin në Stamboll, ishin në Bukuresht, ishin gjithandej dhe u mbledhën të gjithë bashkë dhe na kanë lënë këtë shtet që duhet ta ruajmë si sytë e ballit!

Sepse dua t’ju kujtoj se çfarë shkruante një fëmijë në moshën 16 vjeç, Heroina e Popullit Margarita Tutulani, në një hartim që bënte në shkollë: ‘Më pyet shpesh vëllai i vogël, motër po për çfarë na duhet Atdheu? Atdheu na duhet që të jemi të lirë!’

Kështu që do ta ruajmë Atdheun. Dhe Atdheun, siç thonte i madhi Dritëro Agolli, e kanë shpëtuar këngët edhe malet!

Dhe Dibra shkëlqen në të dyja këto drejtime, sepse këngët kanë përcjellë gjuhën, historinë, trimëritë e të parëve tanë dhe malet kanë qenë kështjellat tona më të pamposhtura. Edhe kur na kanë pushtuar, i kemi tërhequr në male dhe pastaj i kemi hedhur në det.” – u shpreh Presidenti Meta.

HOMAZH

I përkushtuar ndaj detyrës, Atdheut, vartësve dhe eprorëve në çdo kohë

KOLONEL SEJDI VIDRICA

- Oficer e Komandant Shembullor

Nga Ali DEMUSHI*

Me 1 shtator 2020 u nda nga jeta ish kuadri i lartë i Ushtrisë Shqiptare Koloneli në pension Sejdi Adem Vidrica .

Sejdiu lindi në vitin 1942 në fshatin Bujan të Tropojës (Malësi e Gjakovës) në një familje me tradita atdhetare e patriotike, ku gjyshi i tij Sadik Ram Vidrica kishte luftuar përkrah burrave të malësisë, kundër çetnikëve të Malit të Zi, për mbrojtjen e krahinës shqiptare të Plave – Gucise dhe në tetorë të vitit 1913 bie në fushën e luftës, gjatë luftimeve në qafen e Diellit, sot i shpallur Dhëshmor i Atdheut .

Po kështu babai i Sejdiut Ademi, rreshtua gjatë Luftës Nacional Çlirimtare të Shqipërisë, në Bridagën e 25-të Sulmuese të Tropojës e më pas shërben në Komandën e vendit për Tropojën .

Ai gëzon statusin e Veteranit të Luftës Nacional – Çlirimtare.

Sejdiu, shkollën fillore dhe 7-të vjeçare i kreu në vendlindje. Në vitin 1958-1962 studioi e përfundoi shkollën e mesme ushtarake “Skënderbeg” në Tiranë, me rezultate të mira. Nga viti 1962-1964 studioi e përfundoi Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë, me rezultate shumë të mira. U titullua oficer i Ushtrisë me gradën nëntoger. Pasi përfundoi Shkollimin u emërua në detyrë në ish Korpusin e Shkodrës, ku për disa vite shërbeu në zonën e Malësisë së Madhe, në Tamarë e Vermosh si dhe në Dukagjin të Shkodrës .Pasi përfundoi edhe Akademinë Ushtarake të Mbrojtjes (Shtabit të Përgjithshëm), Sejdiu u emërua Komandant i Brigadës Sulmuese të Dukagjinit me qënder në Shkodër. Kjo njësi ushtarake ku drejtoi e komandoi Sejdi Vidrica shtrihej në terrenin më të vështirë, e malorë tërësisht, në rrethin e Shkodrës por pavarësisht vështirësive është dalluar për rezultate të larta në përgatitjen e gatishmërinë luftarake .

Me riorganizimin që u bë në ushtri Korpusi i Shkodrës, kaloi në Strukturën e Divizionit të Këmbësorisë i emëruar Divizioni “Taraboshi” dhe në këtë kuader Sejdi Vidrica u emërua Komandant i Brigadës së Këmbësorisë në Bushat të Shkodrës .

Ajo ishte njësi taktike , ushtarake më e madhja në Divizion, që i takonte të mbronte në rast agresioni të mundeshëm, ndaj vendit tonë, një brez mbrojtje tokësore e bregdetare e pjesërisht malore, përballë Malit të Zi, që nga kufiri me Shëngjinin e deri në Malin e Taraboshit në front dhe në thellësi përfshi Malin e Zef Janës në Bushat dhe Kodrat e Bërdicës në hyrje të qytetit të Shkodrës .

Mund të thuhet se ajo njësi (Brigadë) pati fatin që e drejtoi e komandoi Koloneli Sejdi Vidrica me shtabin e tij, një nga kuadrot më shëmbullore të Divizionit “Taraboshi”, i cili përmbushte të gjitha parametrat e formimit intelektual e profesional .

Ai ishte njeri i mrekullueshëm, me dinjitetin e malësorit të mirë dhe per-



sonalitetin si produkt të vetin, me vlera të mbledha, e këto të dyja qëndronin në unitet me njëra – tjetren në personin e tij, ndaj ishte modeli i urtësisë, thjeshtësisë, dhe shpirtit të sakrificës me ndikim pozitiv të vartës të tij. Ai udhëhiqte gjithë aktivitetin kryesor të Brigadës me shembullin personal. Dallohej në komunikimin me vartësit, e bënte atë të ngrohtë e pa ngritur zërin , me fjalë të zakonshme si të ishte në kuvende burrash të hershëm malësorë

Sejdiu ishte masovik, gëzonte respektin maksimal nga i gjithë efektivi kuadër e ushtar aktive e rezervist, sepse marrëdhëniet e punës dhe ato shoqërore i kishte ndertuar e realizuar nga pozita plotësisht të barabarta pa cënuar ecurinë e detyrës. Askush nuk ia bënte fjalën dyshë sepse edhe urdherat kur i jepte i kishte të menduar mirë që më parë, duke marrë paraprakisht edhe mendimin e vartësve, për vendime sa më të drejta e racionale .

Sejdiu i kapërcente situatat sado të komplikuar , me zgjuarësi, maturi e drejtësi. Tek ai nuk zinte vend uni. I mbronte kuadrot para eprorëve të tij, por edhe i qortonte në ndonjë rast për mangësi në punë, por kurdoherë me

dashamirësi .Kudo e këdo që të takoj nga kuadrot e Brigadës ku drejtoi Sejdi Vidrica veçse fjalë të mira e me superlativa të merituar flisnin për Komandantin e tyre .

Ishte kjo lidhje e pazgjidhshme dhe unike e Komandantit Sejdi Vidrica, me kuadrot dhe efektivin e njëjësive që vazhdimisht Brigada , repartet e nënrepartet e sajë vartëse dalloheshin për stërvitje e gatishmëri luftarake me nivel të lartë në krahasim me repartet e njësitë e tjera të Divizionit .

Vitet e fundit të karrieres ushtarake si oficer aktiv, Sejdiu i kaloi në detyrën e Kryetarit të Degës Ushtarake për rrethin e Tropojës. Edhe aty punoi me përkushtimin maksimal duke realizuar të gjitha detyrat e organizim – mobilizimit ushtarak .

Është për tu theksuar se Sejdi Vidrica, me aftësitë e tija në komunikim, i kishte ndërtuar në mënyrë përfekte marrëdhëniet me organet e pushtetit dhe të ekonomisë në të gjitha zonat ku punoi e drejtoi, duke bërë të mundur realizimin sa më të mirë të detyrave që mbulonte në fushën e mbrojtjes së Atdheut .Sejdiu për rezultate të larta në punë është dekoruar me shumë urdhëra e medalje,

nga organet e pushtetit të kohës .

Reforma në Ushtri e Vitit 1992, pas ndryshimit të sistemit politik në Shqipëri e largoi Kolonelin Sejdi Vidrica nga rradhët e ushtrisë aktive edhe pse ai e disa breza para e pas tij, kanë qënë pjesa më e aftë e kuadrove drejtuese e komanduese të reparteve e njëjësve të ushtrisë tonë deri në majën e piramidës së sajë .

Kolonel Sejdi Vidrica gjatë viteve të shkollimit ushtarak ka qënë edhe një sportist i gjithanshëm, por kryesisht futbollist , i aktivizuar në skudren e shkollës dhe në ekipin e skuadrës rezervë të sport klub “Partizanit”.

Me kalimin e viteve Sejdiu doli në pension, por duke qënë i sëmurë prej disa vitesh shkoi me banim në Tiranë për të qënë sa më pranë Shërbimit Shëndetësor të kualifikuar, po ja që jeta e

solli që ai të ndahet nga familja e shoqëria duke i lënë në pikëllim. Kjo kohë e tejzgjatur që e ka kapluar pandemia virusale na ka paralizuar dhe hequr mundësinë për të përcjellë e dhënë lumturinë e fundit njërvëzve më të dashur të familjeve tona e të shoqërisë .

Kështu ndodhi edhe me ne, shokët, kolegët e miqtë e Koloneli Sejdiu që nuk patem mundësi ti hidhnim një grusht dhe në ndarjen fizike nga ai .Por Sejdiu do jetojë përjetë në kujtesën tonë për të gjitha ato cilësi e virtyte të larta e nga më njezoret që e karakterizonin atë .

Të shumë janë mesazhet e ngushëllimet nga shokët, kolegët e miqtë për Sejdiun si nga brenda e jashtë Shqipërisë me konsideraten më të lartë, por me këtë rast dua të veçoj mesazhin e ngushëllimit dërguar nga ish Komandanti i Divizionit “Taraboshi” , Klonel Enver Gaba, i cili nder të tjera shkruan se Sejdi Vidrica ishte :”njeri i mirë, koleg i respektueshëm, oficer e komandant shembullor e i përkushtuar ndaj detyrës, Atdheut, vartësve dhe eprorëve. Kush pati privilegjin dhe nderin ta njihë dhe të punonte me Sejdiun dhe nuk e ndjeu veten me fat ? Këtë fat e pata dhe unë mbi 5 vjetë me Sjediun. Sejdiu nuk e thoshte kurrë një fjalë të tepërt, nuk i hidhëroi kurrë vartësit apo eprorët e tij . Fliste avash dhe e thoshte mendimin e tij, ashtu siç ishte e vërteta. Nuk jepte premtime që nuk i realizonte. Ishte i ndershëm, një burrë siç thotë populli “nuk vritej për gjak”, ndaj të gjithë kolegët e vartës të donin, e nderonin dhe respektonin pa masë. Edhe sot shokët që punuan me Sejdiun, e ndiejnë veten krenar ” .

Ne shokët , e kolegët e Koloneli Sejdi Vidricës, i shprehim ngushëllimet më të thella familjes, të afërmeve, farefisit, e miqve të Tij për këtë humbje të parakoheshme e me dhimbje të madhe, për ta kaluar sa më lehtë që të jetë e mundur .

Kolonel Sejdi Vidricës i qoftë dhe i lehtë e pushoftë në paqë. I përjetshëm kujtimi i Tij .

***N/Kolonel në pension - Kryetar i OBVL Dega Shkodër**

FESTA

Rrethi i Përmetit i dha luftës 189 Dëshmorë dhe 3 Heronj të Popullit

Përmeti nderon heronjtë, feston 77-vjetorin e çlirimit



Kolonel në pension Muharem Kamani

Muharem Kamani

Më 13 shtator Përmeti u gdhi në festën e çlirimit. Sheshi “Abdyl Frashëri” dhe fasada e përmendores së partizanit ishin zbukuruar me flamurë dhe banderola. Qendra e zërit transmetonte këngë partizane, patriotike dhe marshe. Morën pjesë në këtë festë të shënuar mjaft qytetarë, veteranë dhe pasardhës të familjeve të dëshmorëve, administrata e bashkisë, këshilltarë,



9-Vjeçare “Nonda Bulka”, organizojnë këtë veprimtari festive me vlera të gjithanshme edukative për gjallërimin e jetës kulturore të qytetit. Përmeti i

dhe që do të vazhdojë të eci në rrugën e mëtejshme të zhvillimit.”

I përjetshëm qoftë kujtimi i të rënëve dhe kjo ditë e shënuar e çlirimit të qytetit tonë!

Në emër të OKFD-së, Dega Përmet, fjala ju dha z.Tomorr Kotorri që u ndal gjatë tek kjo datë e shënuar për rrethin e Përmetit, i cili midis të tjerash tha:

“Përkrahja, ndihmesa, angazhimi në rreshtat partizane të 1650 partizan dhe partizaneve të inkuadruar në Br6S, Br12S, tre batalione partizane dhe disa çeta, vërteton kontributin që dhanë përmetaret. Lëvizja antifashiste gjatë viteve 1942-1944 mori përmasa të gjera në rrethin e Përmetit. Partizanët ndiheshin të sigurt në fitore dhe ishin të motivuar të luftonin për mbrojtjen e vendit. Fashistët u goditën nga luftëtarët antifashistë në të gjitha krahinat dhe në qytetin e Përmetit. Mbas çlirimit të krahinës së Dangëllisë, Malëshovës, Ceriës, Rezes, më 13 shtator u çlirua Përmeti, i cili qëndroi i pushtuar 1615 ditë. Rrethi i Përmetit i dha luftës 189 dëshmorë dhe 3 her-

përmendim disa prej tyre: Abedin Shkëmbi, Teki Gjashta, Tako Serani, Sulejman Nurka, Fanjo Cicaku, Agllai Dhimitri, Dhoksi Dhame, Gani Nurka, Mitat Duralliu, Ahmet Tomorri, Anastas Konomi, Arqile Konomi, Gaqo Vinjau, Harallamb Papa, Hamit Hamiti, Karafil Rema, Loni Kristo, Muharem Gjashta, Nako Tanellari, Ngjali Jani, Riza Rakipi, Adem Sheme, Foti Adhami, Dhiogjen Jani, Ilia Koto, Manol Duka, Nikolla Fanko.

Të kujtosh dhe të nderosh ata që dhanë jetën për liri është një detyrim i brezave, është një shenjë respekti që meritojnë dëshmorët e lirisë.”

Në emër të komitetit të veteranëve të Përmetit përshëndeti znj. Flutura Taullai, e cila midis të tjerash tha:

“Qyteti i Përmetit brez pas brezi do të krenohet me historinë e kësaj lufte dhe kontributin e dy brigadave sulmuese dhe disa çetave dhe batalioneve të cilët e vazhduan luftën deri jashtë kufijve për çlirimin e trojeve Shqiptare. Qyteti i Përmetit është dhe do të mbetet qyteti i Kongresit Historik të 24 majit 1944, ku u morën vendime të rëndësishme për çlirimin e trojeve shqiptare. Historia e LANCL është shkruajtur nga fitimtarët dhe nuk mund të ndryshohet nga humbsit sipas mendimeve të fallcifikatorëve të ndryshëm. Ajo pasurohet me fakte dhe dokumenta të reja. Ne jemi të sigurt se historia dhe gjaku i dëshmorëve nuk do humbasin dhe veniten kurrë. Me optimizem ta ndjejmë dhe përjetojmë ndër breza madhështinë e luftës dhe fitoren historike të çlirimit të qytetit të Përmetit”

Festa vazhdoi me koncertin muziko-letrar përparatur nga Qendra Kulturore Multifunkionale dhe shkollat 9-Vjeçare “Nonda Bulka” me udhëheqës artistik Ylli Muço dhe Mimoza Topoviti, këngë dhe marrshe partizane: “Shqiponjat partizane”, “Partizani në luftë po shkonte”, “Malet me blerim mbuluar”, “Nga na erdhën këta partizanë”, “Gjokset djaloshare,”



drejtues të institucioneve kryesore në rreth, nxënës shkollash, të rinj dhe të reja.

Nderuan me pjesëmarrjen e tyre kryetarja e bashkisë Përmet, Znj. Alma Hoxha, nënprefekti Edvin Tuci, nënkryetari i këshillit të qarkut Gjirokastrë, Hodian Selmani, kryetarja e këshillit bashkiak Anila Mihali, sekretarja e përgjithshme e bashkisë Denisa Duro, nënkryetarët e bashkisë Aulona Meshini dhe Florian Hasani, zëvendës kryetarja e komitetit të veteranëve, Flutura Taullai, kryetari i OKFD-së dega Përmet, Tomorr Kotorri, përfaqësues të partive politike dhe shoqatave atdhetare kulturore që aderojnë në rreth. Mbas vendosjes së kurorave dhe tufave me lule pranë partizanit nga personalitetet e pranishme nën tingujt e Himnit Kombëtar, u mbajt në mënyrë solemne një minutë heshtje për të nderuar gjakun e të rënëve dhe sakrificat e partizanëve që sollën lirinë. Cermoninë festive e hapi me një fjalë përshëndetëse nxënësja e shkollës “Nonda Bulka”, e cila midis të tjerash tha: “Bashkia Përmet dhe QKMF dhe në bashkëpunim me shkollën

traditave të shkëlqyera patriotike dhe liridashëse i Rilindasve Abdyl, Naim, Sami, dhe i heronjve të LANÇ-it Musa Fratari, Meleq Gostinishti, Skënder Çaçi dhe dhjetrave dëshmorëve që luftuan me pushkë dhe me penë.

Znj.Alma Hoxha në mes të një entuziazmi festiv përshëndeti personalitetet e pranishëm, manifestuesit dhe midis të tjerash tha: “Mirë se keni ardhur sot në festën e 77 -Vjetorit të çlirimit të Përmetit. Jemi mbledhur të gjithë bashkë në përkujtimin e ditës historike të çlirimit të qytetit tonë, ditë për të cilën kanë sakrifikuar, dhënë jetën dhjetra patriotë e luftëtarë të lirisë. Sot pas 77 -vjetësh në përkujtim të kësaj dite historike me krenari të ligjshme shprehim respektin dhe mirënjohjen për të gjithë ata që u angazhuan në këtë luftë të rëndësishme për lirinë e vendit. Do t'i kujtojmë gjithmonë me respekt të gjithë ata që e deshën qytetin dhe vendin kaq shumë sa derdhën gjak dhe dhanë jetën për të. Kjo ditë çlirimi ishte zanafilla e realizimit të shumë ëndrrave që realizohen sot në Përmet, i cili ka marrë pamjen e një qyteti të vogël dhe të bukur europian



onj të popullit, ndërsa qyteti i Përmetit i ka dhënë luftës 27 dëshmorë. Këta luftëtarë dhe luftëtarë treguan guxim dhe trimëri të rrallë, ku mund të

“Ku e kam vajzën, ku e kam djalin”, recitime interpretuar me nivel të lartë

(Vijon në faqen 10)

PROFIL

Atë e bir, atdhetarë....

• *Dega e Shoqërisë "Vatra", nr:46 në Besebe-Arizona kryesohej nga oparakë, ku me përkrahjen dhe ndihmën e F.Nolit, nxorrën në dritë të vërtetën e rrembimit të Behares, një minorene nga fshati Gjonbabas, e rrëmbyer nga një oficer grek (Pandozollopus) në vitin 1914, ne kuadrin e luftës së Vorio-Epirit*

Nga Liljana Muça

Indicje e këtij shkrimi me profil të dyfishtë, u bë telefonata e Halil Rakip Tudasit (Llapanji), i cili më kërkoi një libër, ku bashkeshorti im i ndjerë Qemal Gegollari kishte shkruar për veprimtarinë patriotike të babait të tij në SH.B.A, si anëtar i shoqërisë "Vatra", dega nr:46 Besebe-Arizona të Bostonit. E teksa ia premtova librin pirja e një kafeje me atë, më bëri të njoh më mirë dy patriotë atdhetar nga fshati Tudas i Oparit. Biseda gjithë emocion dhe krenari për babain, rrodhi natyrshëm nga goja e Halil Llapanjit tashmë 95-vjecar.


Një tufë me dokumenta mbi tavolinë deshmonin më së miri për aktivitetin patriotik, të dy oparakëve atë e bir nga Tudas.

Cili ishte Rakip Tudas (Llapanji)?

Rakipi lindi në fshatin Tudas të Oparit në v.1893 nga një familje atdhetare dhe punëdashëse. Që në moshë të re ndjeu mbi shpatulla peshën e vuajtjeve dhe të shfrytëzimit. Për të siguruar bukën e gojës dhe për një jetë më të mirë, në vitin 1914 emigron në SH.B.A. Atje në Amerikën e largët filloi kalvari i ec e jakjeve, i mundimeve për gjetjen e një pune. Provoi lloje të ndryshme punësh deri në ato më të rendomt, me pagesa minimale. Gjithësesi, vështirësitë ishin sfida për të vlerësuar më mirë mundin dhe djersën e tij. Rakipit iu dha mundësia që të njihej me shumë emigrantë shqiptarë me ide përparimtare dhe sëbashku me ata, punoi fort për të ruajtur ndjenjën kombëtare. Si një ndër veprimtarët e flaktë shqiptarë ai u bë anëtar i Shoqërisë "Vatra", në degën nr:46 të Besebe-Arizona të Bostonit, ku kryetar i asaj dege ishte xhaxhai i tij Feko Tudas. Per shoqërinë "Vatra" dhe për fondin "Shpëtimi i Shqipërisë", Rakipi ka dhënë ndihma te konsiderueshme financiare.

Dega e Shoqërisë "Vatra", nr:46 në Besebe-Arizona kryesohej nga oparakë, ku me përkrahjen dhe ndihmën e F.Nolit, nxorrën në dritë të vërtetën e rrembimit të Behares, një minorene nga fshati Gjonbabas, e rrëmbyer nga një oficer grek (Pandozollopus) në vitin 1914, ne kuadrin e luftës së Vorio-Epirit. Ishte këmbëngulja e Rakip Tudasit, Mestan Gjonbabasit dhe anëtarëve të tjerë të Shoqërisë "Vatra" që vërtetuan në gjyq, se minorenja nga Opari ishte rrëmbyer forcërisht nga oficeri grek, me qellim birësimi. Falë tyre u bë i mundur riatdhesimi i vajzës oparake.


Rakip Tudas (Llapanji) ishte një nga 300 vullnetarët e lirisë, të Shoqërisë "Vatra", të cilët erdhën në Shqipëri në vitin-1920, për të marrë pjesë në Luftën e Vlorës kundër pushtuesve italianë. Në vitin 1922 Rakipi shkon sërish në Amerikë për të vazhduar punën, por edhe si veprimtar i çështjes kombëtare. Me kthimin në Shqipëri (1924) mbas Revolucionit



Demokratiko-Borgjez te Qershorit, ai punon si sekretar i Komunes se Lavdarit dhe më pas si kryeplak i fshatit. Rakipi shquhej si njeri i drejtëpërdrejtë, i prerë dhe i zgjuar. Zotëronte dy gjuhë të huaja dhe gëzonte respektin e bashkëfshatarëve, vullnetarisht mori pjesë dhe drejtoi punimet në hapjen e rruges automobilistike Voskopojë-Gjergjerlicë.

Lufta NÇ e pozicionoi me armë në dorë kundër okupatorëve. Mori pjese ne Luften e Leskovikut dhe të Barmashit. Gjatë Operacionit të Dimrit kur ne Tudas hyne befasisht gjermanët, Rrakipi bën nje akt human, duke shpëtuar partizanen Veko Pojani, e cila punonte ne puntoritë e instaluar ne Tudas. Ai e futi ne shtepi duke i ofruar rroba fshatareje dhe në këtë mënyrë ajo i shpëtoi pushkatimit te sigurtë. Në Operacionin e Qershorit të vitit 1944, Rakip Tudas ishte anëtarë i KNC të fshatit dhe ndihmonte materialisht e moralisht. Shtepia e tij u bë nje nga bazat më të rëndësishme të luftës NÇ. Për merita të vecanta patriotike dhe atdhetare, nga ish presidenti Sali Barisha, me dekret Nr 374 dt.27.11.1992, është dekoruar me "Urdhër për veprimtar patriotike të Klasit të Tretë" me këtë motivacion: "Është aktivizuar me lëvizjen patriotike dhe më 1920 erdhi vullnetar nga SHBA për të marrë pjesë në Luftën e Vlorës".

Halil Rakip Tudas (Llapanji) është i biri i patriotit Rakip Tudasit, i cili mban mbi shpatulla një kalvar jete 95-vjecare. Nis e tregon për peripecitë e jetës nga më të ndryshmet te fëmijërisë, të punës e luftës, deri aktualisht në kohën e sotme ku në mënyrë absurde ai



Rakip Tudas (1893-1980)

ndjen një persekutim politik....

Tregon për kohë të vështira ku të jemes, Hatixhesë I duhej të rriste dhe të kujdesej për tre fëmijët, mbasi Rakipi punonte si emigrant në Amerikë.

Kreu vetëm 4 klasë fillore në fshatin Lavdar, por sic thotë ai "E gjithë jeta ime më pas mu bë si një universitet packa se pa diplomë....." Ishte jo më shumë se 15 -vjec kur punonte me të atin si sipërmarres nderimesh. Fillimisht përpunonte dhe mbante baltën, e më pas edhe pse akoma i ri me cekic e mistri, krahas ustallarëve filloi të ngrinte mur guri. Kurse mosha 18-vjecare e pozicionoi si partizan në Br.9-S, me komandant Irakli Bozo. Gjithësesi para se të dilte partizan ishte aktivizuar vetëm për 4 muaj me rininë balliste. Ndërkohë Halili arsyetonte me të drejtë "A nuk ishte Konferenca e Pezës, një organizim liforcave te ndryshme politike per një luftë të përbashkët kundër okupatorit? Sigurisht që po. Ka patur pjesëtar të një familjeje që u pozicionuan në fronte të kundërta të luftës sic, Isa Kreka me Ballin, ndërsa i biri ra dëshmor i atdheut. Po tani, cfarë duhet t'i themi kësaj....."?!!! Dhe Halil Tudas vazhdon të tregojë, se mbas clirimit të vendit mbeti ushtarak nënoficer efektiv i Ushtrisë në Mbrojtje, përgjatë kufirit të Kolonjës. Për korrektësi dhe disiplinë ushtarake në detyrë, komanda e ushtrisë ku shërbente e propozon për kandidat për t'u bërë anëtar i PPSH, por Komiteti i Partisë së Korcës nuk e aprovoi. Irrevoltuar dhe me ndërgjegje të plotë nga kjo padrejtësi politike vendosi ta lërë ushtrinë në vitin 1950. I kthehet punëve të shumta të jetës së fshatit dhe me humanizmin që e karakterizonte në kohën e zisë së bukës (v.50-54) ka ndihmuar materialisht mjaft familje bashkëfshatare. Për keto vlera njerëzore të Halilit oraganet kopetente të Tudasit e kanë zgjedhur Sekretar Këshilli dhe Kryetar Fronti. (1954-1966)Halili ka dëshmi dhe fleta lavdërimi për mirëbërjen e detyrave të ngarkuara.

Në vitet 90-91 familja shpërngulet në Tiranë për një jetë më të mirë. Gëzon statusin e Veteranit të Luftës dhe në Nëntor të vitit 2012 ftohet si i Ftuar Nderi në 100 -Vjetorin e Pavarsisë. Për meritat patriotike dhe atdhetare të babait të tij, Rakip Tudas, Halili shpirtërisht gjykon se shteti I ka një "borxh" babait të tij në vënien e emrit të një rruge në Tiranë. Kërkesat drejtuar Bashkisë Tiranë në vitin 2014, 2016 dhe 2019 kanë rënë në vesh të shurdhër. Po ashtu i është drejtuar Njesisë Bashkiake Nr.3 dhe Drejtorisë së Artëve dhe Kulturës Tiranë për të njëjtën arsye, por asnjë përgjigje. Të lind natyrshëm pyetja -Përse ?? Administrata e Shtetit ka detyrën legjitime të kthejë përgjigje, sic qytetari ka të drejtën ligjore dhe morale të të dijë përgjigjen sidoqoftë ajo. Atëhere, administrate politike, burokratike apo të dyja bashkë?!

Përmeti nderon heronjtë, feston 77-vjetorin e çlirimit

(Vijon nga faqja 9)

nga instrumentistët, recituesit dhe këngëtarët e shkollës Anxhelo Gace, Kleo Roci, Daniela Shabani dhe Doloreza Sanollari etj.

Për nder të të ftuarve kryetarja e bashkisë znj. Alma Hoxha, shtroi një kokteil në lokal "Përmeti" ku vazhdoi bashkëbisedimi, kujtimet për këtë datë të shënuar dhe ja dha fjalën kryetarit të shoqatës "AK-Përmeti", historianit Kastriot Bezati "Mjeshtër i Madh", i cili me një përshëndetje të shkurtër me pak fjalë foli shumë ku midis të tjerash tha:

"13 Shtatori është ditë e madhe historike për Përmetin. Kjo datë ngrihet mbi datat dhe ngjarjet e

tjera historike si rezultat i luftës e cila solli çlirimin e Përmetit mbi të vërtetën që Përmeti ka lindur rilindësit e mëdhenj të kombit vëllezërit Frashëri. U mbajt kongresi i parë LANÇL-it i njohur si Kongresi Historik i Përmetit, i cili mori vendime të rëndësishme historike për fatet e luftës. Nga Përmeti është udhëhequr LANÇL prej SHP për 77 ditë nga Përmeti dhe Odriçani. Përmeti është i vëmti qytet në shkallë kombëtare i djegur 4 herë nga pushtuesit, prandaj duhet të shpallet nga organet kompetente, qytet martir i Luftës së Dytë Botërore. Gëzuar festën dhe mirëupafshim në kremtimin e datave dhe ngjarjeve të tjera historike të rrethit të Përmetit!"

HISTORIA

Në luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, kjo vatër lirie shkëlqeu krah trevave të tjera



Çeta e Martaneshit në Byshek, në vitin 1912
(Fotografi e Lef Nosit)

Nga Teki Kurti

Martaneshi në të gjithë rrugëtimin e historisë tonë kombëtare ka qenë vatër dhe nyje lidhje e rëndësishme për Elbasanin- Dibrën-Matin e Tiranën, për zhvillimin e luftrave për liri e pavarësi.

Edhe në luftën Antifashiste, kjo vatër lirie shkëlqeu krah trevave të tjera, në ballë të luftës për liri. Me tribunin e lirisë, Baba Faja Martaneshi, kreshnikun Rrahman Lena, drejtuesit: Qazim Aliun, Avram Kojen, Lambi Dishnicën, Jani Fullani, Qazim Peshku, Ferit Myrtezai, Nesebi Ramen, Ibrahim Peshkun, Haxhi Llamin, Hysen Koxherin, Ali Musten, Petrit Hakani, Sali Saliu, Jaho Shehu, Fetah Alcan, etj, bashkë me luftëtarë nga Martaneshi, Kostenja, Neshta e Zërqani, shkruan faqe me germa të arta në historinë e kombit tone.

78- vjet më më parë u krijua çeta partizane e Martaneshi



Dëshmorë të trevës së Martaneshit.

- 1-Baba Faja Martaneshi- Hero i Popullit.
- 2-Shaban Kenga
- 3-Rihane Kenga
- 4-Haxhi Llami
- 5-Muharrem Alhasa
- 6-Demir Alhasa
- 7-Ramazan Alhasa

- 8-Riza Kenga
- 9-Merjeme Kenga
- 10-Rihane Kaça
- 11-Rustem Hasa
- 12-Hajdar Mali
- 13-Hysen Koxherri
- 14-Ramazan Isaku
- 15- Naim Gjoni

Si e kujtoj profesor Sabitin!



Dr Leonidha Peppo*

Për të kujtuar të ndjerin Sabit Brokaj, për ta mbajtur në jetë atë që vdekja nuk mundi ta merrte dot edhe pse më mori një nga miqtë më të mirë, dhe profesorin më të dashur, më duhet të kthehem në vitet e hershme, atëherë ku ka nisur t'i pleks rrënjët njohja dhe konsolidimi i një miqësie.

Në gjysmën e vitit 1981, sapo u ktheva në Tiranë, ngaqë atëherë kur mbarojë studimet, ishte e detyrueshme të shkoje në zonat e vështira e të nevojtura të Shqipërisë, për të shërbyer sipas profesionit. Natyrisht dhe unë në profesionin mjek, si gjithë të tjerët, u emërova në krahinën e Mirditës, në zonën malore të Fanit. Shërbimi aty ndaj popullsisë malësore me jetesën e vështirë, më dha besimin dhe përgjegjësinë e profesionit të mjekut, për të bërë detyrën time, natyrisht të vështirë. Fshati Domgjon mbetet kujtim shumë i mirë i profesionit, por patjetër edhe i jetesës.

Kur erdha në Tiranë fillova nga e para në profesionin tim, ku zgjodha kardiologjinë, sepse këtë pëlqenin prindërit e mi. Atëherë ishte në praktikë që një herë në muaj kardiologët në të gjithë vendin mbledheshin në Tiranë dhe në bazë të një tematike të menduar mirë dhe të përgatitur seriozisht, nxirnin dhe mësonin tema dhe praktika të zhvillimeve të reja botërore të kësaj fushe të klasit të parë. Këto tematika të mësimdhënies udhëhiqeshin nga profesor; Ylli Popa, shef i klinikës kardiologjisë, por në

bashkëpunim të profesorëve të tjerë të mitë, si Pandeli Cina, Anesti Kondili, Sali Berisha, Myzafer Janina. Edhe të rinjve u bëjnë ngritje profesionale edhe të rangut më të lartë.

Meqenëse ishte shkollë e vërtetë e marrjes të të rejave shkencore, vinin edhe mjekë që kishin detyrime të tjera, por aty nuk mungonin. Po çfarë ishin këta?

Mjekë të caktuar në mbrojtje të shëndetit udhëheqës në një klinikë të quajtur speciale, natyrisht këta shiheshin me admirim, sepse ishin të përgatitur, të specializuar jashtë shtetit me përgjegjësi për profesionin e tyre.

Dhe aty, në këto ngritje profesionale pashë dhe degjova nga mjekë, si Sabri Brokaj, Ahmet Kamberi dhe të tjerë të përmendur më lart.

Këta profesorë i shihja dhe në bibliotekën kombëtare, si i vetmi vend në atë kohë për komunikimet shkencore në gjuhën shqipe dhe ato botërore, të shfrytëzoheshin me shumë pasion. Ishte gjithashtu edhe biblioteka e Fakultetit të Mjekësisë, por ishte tjetër gjë nga biblioteka qendrore. Atje vinte dhe Sabit Brokaj, që ishte i njohur aty dhe na përgjigdhite literaturën shkencore mjekësore. Kështu avash-avash, duke u rritur profesionalisht, duke zgjuar admirimin për interesimin tim për sa më shumë përfitim dhe angazhim në fushën e rritjes si mjek, u miqësova me Sabit Brokaj, i cili vinte krenar me borsalinë që e meritonte plotësisht dhe na rriste kënaqësinë të bisedojë me të. Dhe për më tepër na pranonte miqësinë që i ofronim ne më të rinjtë, që përpiqeshim të kopjonim me të mirët, përfshirë dhe atë. I zgjidhnim mjeket e udhëheqjes, sidomos të Enver Hoxhes, natyrisht nga ana profesionale edhe njerëzore, pra ato i kishte të plota, Sabit Brokaj. Miqësia dhe besimin ndaj njeri-tjetrit, që aq e fortë sa na pranonte në shtëpinë e tij për biseda dhe konsultime të mjekësisë, por edhe tematika shoqërore, ku ndër të tjera me interesant ishte që pak kush e di, kur në postin e dekanit të Fakultetit të Mjekësisë u thoshte mjekëve specializantë në Tiranë: “ç’beni këtu, bashkohuni me shokët në Qytetin Studenti”. Pra flitet për protestat e studentëve në vitin ‘90, kurajë intelektuale dhe qytetare, e shfaqur nga plotë intelektualë të tjerë, që shtyu popullin në sukseset e viteve të mëpasshme.

Ndërsa unë edhe të tjerë vazhdonim miqësinë, madje ta forconim atë, derisa arriti që mu dha e dre-



jta ta thërrisja me emër direkt, pa shtuar përpara pjesën që i nderon të tjerët.

Përse erdhi kjo? Sepse Sabiti ishte i singertë, i drejtpërdrejtë, bashkëpunues dhe ndihmues pa mendime të ndryshme që kanë shumë të tjerë. Aq shume u miqësua, sa u bëmë e njëjta me familjen e tij, gruan Mirën dhe fëmijët, Inesën dhe Krenarin. Sillte hare dhe gëzim vajta në shtëpinë e tij. Ishte i aftë të të krijonte harmoni dhe komoditet të mjaftueshëm të kohës, të kaluar aty në familje. Aty kam gjetur edhe personazhe të njohur të profesioneve të ndryshme dhe politikanë të spikatur, duke kërkuar edhe mendime nga ai.

Vitet kalojnë dhe ne mbetëm njëloj në marrëdhëniet tona. Fjalë të ëmbla, probleme dhe mendime, koncepte të trajtuara midis nesh, shkonin në drejtimin e zhvillimeve pozitive e përparësive të nevojshme të bashkëjetesës. E kush s’do të donte të kishte marrëdhënie me këtë njeri kaq perfekt, me përmbajtje për tu admiruar, mbi të gjitha në sjellje, por edhe interesash reciproke. Apo qëndrimi dinjitoz edhe i vendosur i tij, duke dhënë mendimin pa ndrojtje për çdo pikëpamje, qoftë politike apo shoqërore, ku kryesorja ishte patriotizmi i tij.

Por jeta sjell të papritura. Nuk dua të shkruaj për ngjarjen e fundit që më hidhëroi shumë, jo vetëm mua, duke ma shprehur këtë keqardhje edhe shumë miq e shokë, të cilët e dinin miqësinë tonë.

Por ndërsa ai nuk është më, më mbetet në mendje dhe në përfytyrime pamja e tij fisnike, e shëndetshme, gjallëria fizike dhe vitaliteti mendor.

Kështu do të mbetesh Sabit, ashtu siç të njoha!

*Kardiolog, Poliklinika Nr. 4, Tiranë

DEKORIMI

Presidenti Meta vlerëson krijimtarinë produktive dhe cilësore të kryeredaktorit të gazetës “VETERANI”

“MJESHTËR I MADH”, VLERËSIM I MERITUAR PËR GAZETARIN DHE SHKRIMTARIN HALIL RAMA

SHPENDI TOPOLLAJ

Nuk më duket shumë serioze, reagimi i ndokujt, që sa herë Presidenti i Republikës, dekoron figura të shquara të historisë; luftës, punës, artit, kulturës a sportit, nisin nga qesëndisjet, duke aluduar se ai e bën këtë për të shtuar radhët e përkrahësve të tij. Kjo tingëllon sa anadollake aq edhe disi qesharake, po të kemi parasysh se atributi i dekorimeve atij i është dhënë, dhe nga ana tjetër në Shqipëri ka mjaft njerëz që meritojnë të nderohen për cilësitë, vlerat, virtutet, ndershmërinë, përkushtimin, dhe kontributet në shërbim të Atdheut dhe popullit tonë. Qortimi duhet të orientohet nga mos ushtrimi sa duhet i kësaj të drejte, e cila synon për të ngjallur në popull optimizëm, krenari, nxitje për të ndjekur shembullin e më të mirëve. Prandaj, u gëzoja kur këto ditë zoti President vlerësoi në Zall - Dardhë të Dibrës, njerëz të shquar të asaj treve, që i kanë dhënë lavdi asaj. Dhe akoma më shumë, u ndjeva mirë kur midis tyre pashë emrin e mikut tim, njeriut të mrekullueshëm, gazetarit e shkrimtarit të palodhur, demokratit dhe atdhetarit të urtë Halil Rama që ju dha titulli “Mjeshtër i Madh”, me motivacionin: **“Për kontributin e shquar si shkrimtar, skenarist e publicist i cili në veprimtarinë e tij të gjerë ka pasqyruar më së miri historinë, kulturën, traditat e cilësitë identifikuese të shumë viseve shqiptare, veçanërisht të trevës së Dibrës, si dhe vlerat e shumë figurave të shquara të kombit shqiptar”**.

Në 17 librat e tij (letërsi dokumentare) Halil Rama prezantohet si mjeshtër i profilit, duke krijuar personazhe si shembëlltyra që të mbeten në kujtesë. Tërë publicistika e tij është në një linjë vetëpërmbytëse, ku autori me mjeshtëri di të përveçojë protagonistë të veshur me detaje që vetëm syri i mprehtë dhe mendja pjellore i shpërfaq aq mjeshtërisht.

Konti rus Leon Tolstoi duke folur për punën është shprehur se “Pa punë njeriu nuk mund të ruajë dinjitetin njerëzor. Prandaj njerëzit bosh kujdesen për madhësitë e jashtme”. E solla këtë thënie të mençur, pasi më duket më i merituari për Halil Ramën, i cili në çdo vend ku ka punuar, ka mbetur po ai; i thjeshti, kokëuluri, dashamirësi, i qeshuri, fjalëpak, pajtuesi dhe përherë, i palodhuri. Kjo është dhe arsyeja përse ky gazetar e shkrimtar i pa bujë është kaq dinjitoz, dhe ka aq shumë miq e shokë, gjë që bije në sy menjëherë në vaprimtaritë që organizon me shokët e tij, ku gjithmonë salla do të jetë e mbushur, me pjesëmarrës të të gjitha fushave. Nga viti 2003 që Halil Rama drejton gazetën “Vetëra-



• **Vlerësimi nga Presidenti Meta për publicistin e shkrimtarin Halil Rama, bazuar në propozimet e tri shoqatave: firmosur nga kryetari i OBVL-së, kolonel Ing. Myfit Guxholli, nga “Bashkësia Dibrane”, firmosur nga kryetari i saj prof. Bujar Kapexhiu – “Nderi i Kombit” dhe sekretari i Përgjithshëm prof. dr. Saimir Shatku – “Mjeshtër i Madh”, dhe nga Presidenti i Shoqatës “Ansambli Kuvendi Zall Dardhë”, Z. Neshat Ndreu**



Me këshilltarët e Presidentit Meta, z. Ylli Asllani e z. Shems Prençi dhe z. Dritan Ylli - drejtor i protokollit të Kryetarit të shtetit

ni” organ i OBVL, çdo lexues ka gjetur në shkrimet e botuara, evokimin e ngjarjeve madhore të Kombit, përpjekjet për liri në shekuj, epopenë e lavdishme të Luftës Nacional - Çlirimtare, rolin e atyre që drejtuan formacionet partizane, kujtimin e dëshmorëve që dhanë jetën për atdhe, ndeshjen me bishën serbe të

UÇK - së në bashkëpunim me Forcat e NATOS, ndikimin e SHBA në pavarësinë e Kosovës, dëmin që si kudo edhe te ne solli ideologjia komuniste, dhe kurrë nuk mund të gesh një rresht të vetëm që të mbjellë përçarje.

Halilin, intuita e ka orientuar drejt madhështisë së një burri të papërsëritshëm, Heroit të Popullit, Nderit të Kombit, gjeneral - lejtant Rahman Parllakut. Ai ka parë te ky personalitet i rrallë, genin shqiptar, të cilin nuk e thyen padrejtësitë e kohës, vuajtjet fizike dhe shpirtërore, nuk ja mpinë qartësinë e gjykimit as vitet e gjata të burgut dhe as dramën familjare, dhe që nuk i lejojnë asnjëherë vetes që të ngrinte kokë ndjenja e hakmarrjes. Halili e lançoi staturën e tij prej patrioti të madh, brenda mundësive që lejonte arti gazetaresk dhe shkroi monografi të shkëlqyer për gjithësa ai bëri si drejtues ushtarak, politikan dhe Kryetar i OBVL. S’duhet harruar se edhe vetë i ndjeri dhe i paharruari Rahman Parllaku, e donte me gjithë shpirt Halil Ramën dhe e merrte kurdoherë me vete, kudo që shkonte anë e kënd vendit. Por me fisnikërinë e shpirtit të tij, Halili ka lartësuar dhe përjetësuar në shumë e shumë libra, plot burra e



gra që nuk kursyen asgjë për popullin e vendin e tyre. Nga ana tjetër, Halili, jo vetëm si gazetar me përvojë, por edhe si jurist, bën analiza të fuqishme në faqet e shumë gazetave të përditshme, duke u paraqitur si një opinionist vizionar e me kurajë dhe aspak partiak.

Për Halil Ramën e para është Shqipëria. Ai gjithmonë ka pasur për devizë thënien e poetit salaminas Euripidit “O, kurrë mos u lodh për ndihmën që i jep Atdheut!” Ndaj dhe Atdheu e shpërblen birin e tij me atë titullin e lartë “Mjeshtër i Madh”, si mirënjohjeje.

